

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendim Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027”; Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri”. Programi Qeverisës 2021-2025
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	6.2.2025 - 6.3.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	21.05.2025
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 4.2.2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025-MBZHR-Nr. 2
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Adra Gjongecaj <i>e-mail-i:</i> Adra.gjongecaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0692325402 Entela Kola <i>e-mail-i:</i> Entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Alban Isufi <i>e-mail-i:</i> Alban.isufi@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0696599747
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i>	

Problematikat të cilat janë evidentuar në këtë sektor të bujqësisë lidhen me mospërputhjen e ligjit në fuqi me zhvillimet ndër vite në sektorin e bujqësisë, veçanërisht në drejtim të kultivimit dhe menaxhimit të drufrutorëve. Është evidentuar mungesa e përditësimit të nevojshëm i cili do të pasqyroste ndryshimet në politikat bujqësore, në strukturat institucionale dhe në nevojat bashkëkohore të fermerëve, duke sjellë një mospërputhje të theksuar midis kuadrit ligjor dhe realitetit në terren. Kjo mungesë koherence ka ndikuar në zbatueshmërinë e ligjit dhe ka kufizuar mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt tregut në sektorin e drufrutorëve. Përveç problematikave që lidhen me rrezikun ndaj sektorit të drufrutorëve, veçanërisht ullirit, si pasojë e zhvillimeve territoriale, pasigurisë së sektorit dhe pasigurisë së investimeve nga fermerët, do të trajtohet edhe përditësimi i emërtesave të institucioneve të varësisë, të cilat kanë kaluar në procese riformimi dhe ristrukturimi.

Ashtu siç theksuam edhe më lart, Ligji Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve” nuk është ndryshuar që nga miratimi i tij në vitin 1995, ndërkohë që janë miratuar ligje dhe akte nënligjore, që në mënyrë direkte ose indirekte prekin zbatimin e këtij ligji. Në tërësi mjedisi rregullator është i ndryshëm nga viti 1995, çka ka sjellë nevojën e ndërhyrjes në tekstin ligjor në fuqi.

Po ashtu, për shkak të reformave institucionale të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe reformës administrative territoriale që aplikohet nga viti 2015, institucionet e përcaktuara në ligj janë mbyllur ose reformuar në raport me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre. Në këto kushte është i nevojshëm zëvendësimi i emërtesave dhe ripërcaktimi i përgjegjësiave që do ushtrojnë institucionet e ngarkuara nga ligji.

Rëndësia që paraqesin drufrutorët në bujqësi vë theksin në kërkesën për zgjidhjen e disa problematikave siç është afektimi nga zhvillimet e ndryshme të territorit dhe rreziku që paraqet kjo për drufrutorët, duke pasur në vëmendje se disa lloje drufrutorësh, siç janë ullinjë të cilët kanë jetëgjatësi shekullore me mbi 100 vite.

Moskoherenca ligjore përbën një problem serioz, e cila cënon potencialin e zhvillimit afatgjatë të sektorit bujqësor, duke ndikuar negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e kulturave drufrutore, të cilat kanë karakteristika specifike dhe kërkojnë një qasje të dedikuar dhe të vazhdueshme.

Konkretisht, drufrutorët si ullinjë, fiku, qershia, pjeshka etj. janë kultura shumëvjeçare që kërkojnë mbrojtje të posaçme për shkak të kohës së gjatë të prodhimit dhe kontributit të tyre ekonomik, mjedisor dhe kulturor në territor. Megjithatë, zhvillimet urbane, ndërtimet pa planifikim dhe mungesa e një kornize ligjore të qartë që garanton mbrojtjen e këtyre kulturave kanë sjellë pasoja konkrete si dëmtim të plantacioneve ekzistuese, shndërrim të tokave bujqësore në funksione të tjera si dhe humbje të investimeve afatgjata të fermerëve.

Shkaku kryesor i kësaj problematike qëndron në mungesën e përditësimit dhe harmonizimit të legjislacionit aktual me ndryshimet strukturore, mjedisore dhe socio-ekonomike që kanë ndodhur në sektorin e bujqësisë. Ligji në fuqi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të mjaftueshme rëndësinë që kanë drufrutorët në zhvillimin e qëndrueshëm rural, nuk parashikon masa të qarta mbrojtëse për to, përballë ndërhyrjeve në territor, dhe nuk garanton integrimin e tyre në politikat zhvillimore afatgjata.

Mungesa e një qasjeje të integruar ndërmjet zhvillimit të territorit dhe mbrojtjes së trashëgimisë bujqësore ka krijuar një boshllëk institucional dhe ligjor, ku drufrutorët mbeten të pambrojtur ndaj presioneve të tregut, urbanizimit dhe mungesës së planifikimit. Projektligji nuk lidhet me ndërhyrjet për shkak të legjislacionit për shpronësimet për interes publik dhe atij për shëndetin e bimëve. Të gjitha këto kanë çuar në propozimin e ndryshimit të kuadrit ligjor aktual në fuqi duke dhënë zgjidhje cështjeve të rëndësishme të parashtruara.

Grupet e prekura nga ky problem janë:

- Operatorët e bizneseve të frutave që vijnë nga drufrutorët, tregëtarët e fidanëve etj.
- Qeveria;
- Fermerët kultivues;
- Komuniteti dhe shoqëria civile.

Kjo nismë ka si qëllim ofrimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për arritjen e disa qëllimeve siç janë: vënia në efikasitet të tokës bujqësore, garantimi i ecurisë në një linjë me risitë që parashikojnë standardet evropiane, përputhshmëria me objektivat kryesore të ministrisë, mbrojtja e pemëtorëve, interesave të shfrytëzuesve të tokave bujqësore, mbrojtjen mjedisore, sigurimin e zhvillimeve territoriale pa efekte negative në bujqësi etj.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Përditësimi 100% i emërtesave dhe kompetencave të institucioneve përgjegjëse, menjëherë pas hyrjes në fuqi të projektligjit.
2. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore përmes rritjes me 10% të sipërfaqeve të mbjella me pemë drufrutore, në krahasim me kulturat e tjera bujqësore, brenda një periudhe 5-vjeçare nga hyrja në fuqi e projektligjit.
3. Ruajtja e 10% të fondit të rrënjëve të ullirit përmes zhvendosjes së tyre, në rastet e lejuara nga planet e zhvillimit të territorit, brenda një afati 10-vjeçar nga hyrja në fuqi e projektligjit.
4. Garantimi i mbrojtjes së ullirit, koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimëve me vlera gjenetike, brenda një afati 6-mujor nga miratimi i projektligjit.
5. Vendosja e ndalimeve për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtjeje, menjëherë me miratimin e ndryshimeve ligjore.
6. Sigurimi i mbulimit të kostove të zhvendosjes së rrënjëve të ullirit, nga subjekti zhvillues/pronari ose nga buxheti i shtetit, sipas rastit të projektit, brenda një afati 12-mujor nga miratimi i ndryshimeve ligjore.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime legislative, nënkupton lënien pa zgjidhje të problematikave të evidentuara.

Opsioni 1 - (rregullator): Paraqet mundësinë e miratimit të një ligji të ri dhe shfuqizimin e ligjit aktual Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”. Ky nuk është opsioni i përshtatshëm për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sepse në këtë mënyrë nuk trajtohen, zgjidhen një sërë çështjesh problematike në kohë duke mos dhënë kështu rezultatet e duhura.

Opsioni 2 - (rregullator): Është opsioni i rishikimit të Ligjit Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, duke rregulluar disa çështje sipas objektit. Ky opsion paraqet opsionin më të mirë për të arritur qëllimet që ka institucioni në adresimin e problematikave në mënyrë efikase, të shpejtë dhe konkrete. Përditësimi i ligjit në fuqi jep mundësinë e arritjes në mënyrë të kënaqshme të objektivave që janë evidentuar.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të materializohej përmes disa formave ku përmendim forcimin e zbatimit të ligjit aktual në fuqi nga strukturat kompetente egzistuese, trajnimin e stafit, forcimi e kërkesës së llogarisë, rritja e eficientës së strukturave përmes përforsimit të kompetencave të tyre etj. Qeveria mund të fokusohet në zbatimin të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues në mënyrë më rigorozë, zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin sidomos në aspektin e përfuturimit të njohurive mbi teknikat inovative në kohë etj. pa nevojën e miratimit të rregullave të reja legislative.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i zgjedhur nga MBZHR në këtë rast është **Opsioni 2 (rregullator)** i cili parasheh miratimin e ndryshimeve ligjore duke ofruar kuadrin ligjor rregullator të nevojshëm për vënien në efikasitet të tokës bujqësore duke siguruar kështu që ligji të jetë në një linjë me risitë që parashikojnë standartet europiane dhe në përputhje me objektivat kryesore të ministrisë, mbrojtjen e pemëtorëve, interesave të shfrytëzuesve të tokave bujqësore, mbrojtjen mjedisore, sigurimin e zhvillimeve territoriale pa efekte negative në bujqësi etj.

Grupet e prekura:

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

1. **Qeveria** - nxit hartimin dhe miratimin e politikave aktive pozitive në aspektin e zhvillimeve ekonomie, tregëtinë, zhvillimin e bujqësisë, vënien në efikasitet të tokave bujqësore rritjen e investimeve dhe të prodhimit të frutave që vijnë nga drufrutorët etj.
2. **Fermerët** - të cilët kanë veprimtari bujqësore të tyren kultivimin e drufrutorëve përfitojnë pasi nuk rrezikohen nga mundësia për prerje të panevojshme të produkteve të tyre duke qënë se ligji parasheh përdorimin e disa metodave për zhvendosjen e tyre apo për kushtëzimin e procesit të prerjes me marrjen e aprovimit paraprak etj. Kjo sjell prodhimtari në vijim, stabilitet e siguri më të

madhe për fermerin i cili nuk do të rrezikohet nga ndryshimet eventuale të zhvillimeve territoriale, ndryshimi i statusit juridik të tokkës bujqësore, mbarimi i kontratës së qiramarrjes etj.

3. **Komuniteti dhe shoqëria civile**- si rezultat i zbatimit të ndryshimeve ligjore ka përfitime në aspektin social përmes modernizimit të sektorit bujqësor, përmirësimin e cilësisë së frutave, rritje të mirëqënies, ushqim me siguri më të lartë, përmirësim ekonomik në zonat rurale, zhvillim i bujqësisë etj.
4. **Punëmarrësit** - më shumë vende pune në fushën në sektorin e bujqësisë, rritje e kushteve optimale të punës, mundësimin e punësimit të ekspertëve teknikë si pasojë e përdorimit të teknologjive moderne.
5. **Operatorët e bizneseve**- të cilët mund të jenë tregëtarë, grumbullues, eksportues të prodhimeve të drufrutorëve, apo tregëtues të plehërave kimikë/organikë të cilët përdoren për shëndetin e tyre etj. do të përfitojnë nga rritja e këtij projekligji pasi drufrutorët nuk do të rrezikohen më nga prerjet e panevojshme, të cilat shkaktohen nga përfundimi i kontratës së qirasë së tokës bujqësore apo zhvillimet e territorit etj. Stabiliteti i tillë ka pritshmëri të këtë efekte pozitive si rritjen e prodhimit, qëndrueshmëri në këtë sektor etj. Prodhimi i fidanave të ullirit është kompleks, pasi aktiviteti i fidanishteve nuk mund të konceptohet i ndarë nga kërkesat e tregut të prodhuesve të ullirit, nga mbështetja e tyre nga institucionet shkencore dhe autoritetet qeveritare.

2. Ekonomike:

- Rritja e ekonomisë dhe stabiliteti për fermerin, i cili nuk rrezikohet më për zhvillimet e ndryshime territoriale duke rrezikuar mirëqënien e pemëve drufrutore, sidomos ata me jetëgjatësi shumë të gjatë sic janë ullinjët.
- Më shumë dhënie me qira për qëllim të zhvillimit të aktivitetit të mbjelljes së drufrutorëve për shkak të stabilitetit dhe mosrrezikimit nga zhvillimet e ndryshme territoriale, aplikimin e taksave lehtësuese etj.
- Burim i qëndrueshëm ushqimi dhe ekonomie veç përfitimeve mjedisore sepse pemët frutore ofrojnë një burim të qëndrueshëm ushqimi dhe mund të kontribuojnë pozitivisht në ekonominë lokale përmes prodhimit të frutave.

3. Mjedisore:

- Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, ndikohen pozitivisht nga zonat e gjelbra duke përfshirë këtu edhe kultivimin e drufrutorëve, egzistenca dhe mirëqënia e të cilëve tashmë ndikohen në mënyrë më të reduktuar nga zhvillimet e ndryshme territoriale apo ndryshimet e statusit të tokës bujqësore.
- Reduktimi i nditjes së ajrit- pemët konsumojnë dioksid karboni (CO) dhe çlirojnë oksigjen, duke ndihmuar në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe ndikimin nga efektet e ndryshme klimatike;
- Ruajtja e tokës dhe parandalimi nga eurozioni sepse rrënjët e drufrutorëve ndihmojnë në stabilitetin e tokës, duke parandaluar eurozionin e tokës si dhe duke parandaluar rrëshqitjen e dheut veçanërisht në zona me terren të pjerrët;
- Përmërsimi i biodiversitetit sepse këto pemë krijojnë habitat për zogjtë, insektet dhe speciet e tjera, duke kontribuar në ekosisteme më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme;
- Reduktimi i ndotjes së ujit pasi pemët ndihmojnë në filtrimin e ndotësve nga uji i shiut para se ai të depërtojë në tokë ose të përfundojë në lumenj dhe liqene.

Kosto dhe Përfitime:

Kosto të Sektorit Privat: Përfshijnë investime fillestare për përmbushjen e standardeve, modernizimin e teknologjisë dhe trajnimin e personelit.

- **Përfitime të Sektorit Privat:** Rritje e produkteve si rezultat i përdorimit të teknologjive të reja, përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore, rritje e eksporteve si dhe rritja e të ardhurave nga prodhimi, tregëtimi dhe eksporti.
- **Kosto dhe Përfitime të Sektorit Publik:** Nuk identifikohen kosto të reja të konsiderueshme për sektorin publik, pasi strukturat ekzistuese do të ushtrojnë kompetencat sipas ndryshimeve ligjore. Përfitimet përfshijnë rritjen e të ardhurave nga taksat dhe doganat, si dhe përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë në plan afatgjatë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar:

Nga analiza me shumë kritere e kryer për opsionet tregoi se **Opsioni 2** i cili parashikon hartimin e ndryshimeve ligjore në Ligjin Nr. 7929/1995 “Për mbrojtjen e drufrutorëve” është vlerësuar më me shumë pikë duke u zgjedhur nga ana jonë si opsioni i preferuar. Ky opsioni është zgjedhur si opsioni i duhur, më i përshtatshëm dhe më i zbatueshëm.

Opsioni 2 (rregullator) ofron qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me mënyrat dhe teknologjitë e reja dhe ka pritshmëri të lartë për efektin pozitiv lidhur me cilësinë dhe pjellorinë e tokës në kushtet kur si rezultat i përdorimit intensiv dhe shpesh pa kritere të ekosistemeve natyrore klima në tërësi ka pësuar ndryshime negative duke rezultuar në ngrohjen globale. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë. Zgjedhja e këtij opsioni si opsioni i preferuar do të bëjë të mundur rritjen katër fusha të rëndësishme në të njëjtën kohë:

1. Ekonomi;
2. Garantimi i cilësisë së ushqimit;
3. Shëndeti i kafshëve;
4. Përmirësimi i kushteve mjedisore.

Ndryshimet ligjore të propozuara kanë për qëllim përditësimin e ligjit aktual i cili është miratuar në vitin 1995 dhe si i tillë ka nevojë për përditësim për t’iu përshtatur dhe për të qënë në koherencë me ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në bujqësi. Ndër risitë që sjell ky projekligj po rendisim:

- Si kryhet prerja dhe marrja e miratimit për të?!
- Cilët janë llojet e drufrutorëve të cilët lejohen të priten si dhe arsyet për këtë?!
- Procedura e miratimit të lejes për prerjet etj.
- Rregulla lidhur me zhvendosjen e drufrutorëve si dhe parashikime lidhur me kundrvatjet administrative.

Propozimi ynë konkretisht shton nenin 8/1, dedikuar për ulla, koleksionet e pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimët e veçuara që kanë vlera gjenetike.

Është mbajtur në konsideratë fakti se ulliri mbillet për prodhim, dekoracion, si dhe ka jetëgjatësi më të madhe se pemëtoret e llojeve të tjera. Ndryshe nga pemët frutore, agrumet dhe vreshtat, që hyjnë në prodhim shumë shpejt dhe kanë një cikël prodhimi që shkon deri në 50 vjet në varësi të kulturës dhe llojit të kultivarit, ulliri hyn në prodhim më vonë dhe ka jetëgjatësi shekullore. Projektligji lejon zhvendosjen e rrënjëve të ullirit nga zhvilluesi në bashkëpunim me pronarin e tokës, vetëm në rastet ku ka leje ndërtimi të miratuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në këto raste zhvendosja e rrënjëve të ullirit ndodh për shkak se toka ndryshon destinacionin për ndërtim, pas kalimit të gjithë fazave ligjore deri në miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit. Në këtë mënyrë ruhet numri i rrënjëve të ullirit pavarësisht dinamikave që ka planifikimi dhe zhvillimi i territorit. Kostot për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit përballohen nga subjekti zhvillues/pronari.

Duke njohur rëndësinë e koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimët e veçuara që kanë vlera gjenetike, lejohet zhvendosja vetëm në rastet ku ka leje objekte publike të miratuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zhvendosja kryhet nga zhvilluesi në bashkëpunim me pronarin e tokës. Kostot e zhvendosjes përballohen nga buxheti i shtetit i alokuar për realizimin e projektit. Ndërkaq neni 8/1 përcakton gjithashtu dhe ndalimet për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtje. Projektligji që propozohet prek veçanërisht rrënjët e ullirit të cilat janë më problematike për shkak të kushteve dhe jetës së gjatë që ka pema e ullirit.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI PUBLIK

Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 6.2.2025 deri më 6.3.2025. Në këtë periudhë përfshihet konsultimi përmes Regjistrisë Elektronike. Numri i shikimeve në RENJKP ishte 233. Nuk ka komente përmes Regjistrisë Elektronike. Numri i shikimeve në RENJKP ishte 233.

Metoda e konsultimit, e përdorur për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, janë:

- Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike, REKNJP, nga data 6.2.2025 deri më datë 6.3.2025.

Procesi i konsultimit të projektligjit, është mbyllur pa komente.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji, nga ana e MBZHR-së dhe disa institucione të varësisë, dhe të tjera siç vijon:

- 1) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- 2) Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve;
- 3) Drejtoritë Rajonale të Ekstencionit Bujqësor;
- 4) Bashkitë, përkatësisht Drejtoritë përgjegjëse për bujqësinë në bashki;
- 5) Institucionet përgjegjëse për kulturat drufrutore.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qëndror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ushtron drejtimin teknik dhe administrativ të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara me mbrojtjen e tokës. MBZHR kryen monitorimin përmes institucioneve të saj të varësisë AKVMB-së të cilët raportojnë gjetjet apo masat administrative të marra në këtë kuadër pranë ministrisë.

- **Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve** - merr masa për evidentimin e risqeve sipas fushave të përgjegjësisë, të dhënat raportohen menjëherë në institucion për mundësimin e miratimit të planeve për t'u zbatuar, akteve ligjore/nënligjore për shmangien e vonesave apo risqeve. Monitorimi i zbatimit të ligjit në terren kryhet nga AKVMB si autoritetit i cili ka kompetenca edhe marrjen e masave administrative në rastete e evidentimit të kundërligjshmërisë.

- **Drejtoritë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor** – ushtrojnë kompetencat e tyre si në aspektin e monitorimit/këshillimit po ashtu edhe të ndërmarrjes së masave në aspektin fitosanitar.

- **Bashkitë, përkatësisht drejtoritë përgjegjëse për bujqësinë**- në bashki ushtrojnë kompetenca në zbatim të ligjit dhe kanë detyra monitoruese/këshilluese mbi tokat bujqësore në administrim të bashkive.

- **Institucionet përgjegjëse për kulturat drufrutore**- Institucionet e tilla janë të ndryshe në sektorin privat apo në formën e ofj-ve të pavarura të cilët luajnë rol në publikimin e studimeve për kultivimin e e drufrutorëve, zhvillimin e kësaj fushe përmes metodave inovative, shëndetin e frutave, japin ndihma mbështetëse sektorit shtetëror në këtë fushë, ofrojnë asistencë etj.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së opsionit të preferuar do të kryhet nga drejtoria përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucion përgjegjës për hartimin për tokat bujqësore në administrim të saj.

Monitorimi në terren në lidhje me objektivat ligjore për tokat bujqësore do të kryhet nga MBZHR dhe institucionet e saj të varësisë, në bashkëpunim me bashkitë, këshillat e qarqeve, prefekturat dhe strukturat e tjera të ngarkuara nga ligji në fuqi.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit është i ndarë mes Drejtorisë/Sektorit të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore dhe Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës po ashtu në Ministri.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Bujqësia ka qenë një ndër shtyllat kryesore të Shqipërisë për shekuj me radhë dhe drufrutorët zënë një vënd të rëndësishëm në këtë sektor. Shqipëria me klimën e saj të ndryshme, nga zonat malore në veri në zonat mesdhetare në jug, ka kushte të favorshme për kultivimin e një larmie të gjërë drufrutorësh. Fermerët përdorin pesticide biologjike për të mbrojtur frutat por gjithnjë e më tepër po përdoren metoda miqësore me mjedisin. Rëndësia ekonomike dhe tregtimi i drufrutorëve përbëjnë një pjesë të konsiderueshëm të prodhimit bujqësor në Shqipëri. Ata përdoren për konsum të freskët apo si përpunim si p.sh. reçel, lëngje frutash, raki etj. dhe eksport.

Sfidë për sektorin mbeten ndryshimet klimatike, temperaturat e larta dhe mungesa e reshjeve gjë që ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e prodhimit të frutave. Disa fusha të cilat kërkojnë investime për tejkalimin e problematikave që hasen në këtë sektor janë:

- Rritja e investimeve në teknologji dhe infrastrukturë moderne;
- Mbështetja e fermerëve me trajnime dhe subvencione;
- Promovimi i produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

Shqipëria ndodhet në zonën klimatike nëntropikale (mesdhetare). Ky territor shtrihet në zonën bregdetare të detit Mesdhe. Në këtë zonë mbizotëron klima nëntropikale (mesdhetare) e cila karakterizohet nga verë e thatë dhe shumë e nxehtë dhe me dimër të butë e me shi. Dëbora është një dukuri e rrallë në këtë zonë, me përjashtim të maleve më të larta. Klima në Shqipëri është mesdhetare në pjesën bregdetare dhe në zonën malore ndihet klima e butë-kontinentale dhe malore. Shqipëria ka një shumëllojshmëri klimash. Me vijën bregdetare të saj përballë detit Adriatik dhe detit Jon në detin Mesdhe, malet që shtrihen në një gjerësi gjeografike me një sërë modelesh të ndryshme të motit gjatë stinës së dimrit dhe verës, krijojnë kështu një numër relativisht të madh të rajoneve klimatike, për një zonë kaq të vogël. Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, ndërsa zonat malore kanë klimë kontinentale. Si në ultësira ashtu edhe në brendësi, moti ndryshon ndjeshëm nga veriu në jug. Ultësirat bregdetare kanë klimë tipike mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të thatë. Temperaturat mesatare variojnë nga 7°C në dimër deri në 24°C në verë. Zona malore karakterizohet nga një klimë mesdhetare-kontinentale, e shkaktuar nga masat ajrore që dominojnë Evropën Lindore dhe Ballkanin. Karakteristikat kryesore të kësaj zone janë erërat e forta me drejtim verior dhe verilindor si dhe temperaturat mesatare pak më të ulëta. Sasia e reshjeve është mesatarisht e lartë si rezultat i kombinimit të dy rrymave ajrore, mesdhetare dhe kontinentale. Niveli i reshjeve varion nga 600 mm në vit në luginën e Korçës, në 3100 mm në vit në Bogë, në alpet shqiptare, 95% e reshjeve bien në stinën e dimrit¹. Sipërfaqja totale bujqësore e kultivuar e Shqipërisë është rreth 510,000 hektarë, e detajuar siç paraqitet në tabelën 2.

Tabela 2².

¹ Urdhër Nr. 578, datë 2.12.2022 “Për miratimin e Planit të Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, 2022–2032”.

² Burimi: INSTAT-i dhe të dhënat e përmbledhura të MBZHR-së.

Emërtimi	Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas përdorimit	
	2019	2020
	Total (ha)	Total (ha)
E kultivuar (përfshirë drithërat, perimet, bimët mjekësore, foragjere etj.)	417,000	421,607
Kulturat e përhershme total (pemë frutore, ullinj, agrume, vreshta)	85,838	86,912

Shumica e fermave janë të përziera dhe karakterizohen nga parcela toke dhe tufa bagëtish të vogla. Bujqësia përbën rreth 20% të PBB-së së vendit. Ndërkohë që sipërfaqet totale të kultivuara (tabela 2) me bimë arash janë relativisht të qëndrueshme, pemët frutore, ullinjtë, agrumet, perimet në fushë të hapur dhe mbi të gjitha perimet në serra, janë rritur ndjeshëm në vitin 2021 krahasuar me vitin 2015, duke treguar një rritje graduale të orientimit të bujqësisë për treg (tabela 3).

Tabela 3.

Kulturat (000 ha)	Viti							Ndryshimi 2015 - 2021
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Totali i kulturave të kultivuara, nga të cilat	413.100	419.000	424.200	420.300	417.000	421.600	420.600	1.8%
Drithërat	142.600	148.000	145.700	140.100	132.200	131.311	134.300	-5.82%
Foragjeret	207.300	208.600	215.700	217.400	220.100	225.024	219.700	5.98%
Perime dhe pjepër	31.100	31.200	31.900	31.700	33.000	33.502	33.500	7.72%
Perime në serra	1.244	1.406	1.540	1.650	1.734	1.798	1.878	50.96%
Pemishte (000 pemë)	Viti							Ndryshimi 2015 - 2021
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Pemë frutore	12.405	12.594	13.130	13.393	13.822	14.038	14.286	13.17%
Pemë ulliri	9.225	9.608	9.786	10.008	10.288	10.532	10.746	16.49%
Pemë agrume	1.282	1.354	1.394	1.454	1.521	1.589	1.644	28.23%
Vreshta (ha)	10.438	10.533	10.965	10.787	10.842	12.002	11.057	5.93%

Sistemet e vogla të prodhimit përfaqësojnë një nga kufizimet kryesore për rritjen e mëtejshme të qëndrueshmërisë ekonomiko-financiare të fermave. Gjithashtu, madhësia e vogël e fermave ka nxitur krijimin e instrumenteve të politikës publike që synojnë të lehtësojnë aksesin e fermerëve në mbështetje financiare përmes pagesave direkte, inputeve me kosto më të ulët, apo kredive të favorshme. Këto instrumente orientohen drejt nxitjes së bashkëpunimit mes fermerëve në faza të ndryshme të prodhimit dhe/ose të tregtimit. Referuar Strategjisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 - 2027, pragu i qëndrueshmërisë ekonomike të fermës duhet parë si dinamik, në varësi të çmimeve

të tregut, kostos së jetesës dhe faktorëve të tjerë, që mundësojnë vazhdimin e aktivitetit ekonomik në zonat rurale. Studimet sektoriale të përgatitura në vitin 2021 tregojnë si madhësi minimale për qëndrueshmërinë ekonomike të fermës njësinë prej 0.20 ha në rastin e serrave, 0.5 ha për fermat e agrumeve, 0.90 ha për vreshtat, 1 ha për perimet në fushë dhe pemëtoret dhe 2 ha për fermat e ullirit. Megjithatë, një qëndrueshmëri e shëndoshë ekonomike mund të arrihet vetëm në pragje më të larta, pasi fitimi nga fermat të tilla të vogla mund të mos mbulojë nevojat financiare të familjes, dhe në kushtet kur aksesit në rritjen e nivelit të sipërfaqes është i kufizuar, rritja e qëndrueshmërisë mund të prodhohet nga bashkëpunimi midis fermerëve apo dinamizmi i tregut të qiradhënies së tokës³.

Të dhënat e tabelave 1 dhe 2 kanë si burim INSTAT dhe paraqesin zhvillimet në bujqësi ndër vite.

Tabela 1: Frutat - sipërfaqja e kultivuar dhe prodhimi në Shqipëri (2018-2020)

Fruta	Sipërfaqja (ha) në total				Sipërfaqja e prodhimit (ha)				Prodhimi (tonë)			
	2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021	2018	2019	2020	2021
Pemë frutore (total)	19958	20361	20658	20682	16669	17232	17496	17488	274.343	274423	273749	287210
Mollë	4.706	4.761	4.814	4658	4.294	4407	4420	4242	108.375	107713	102167	111247
Kumbulla	2.905	2.919	2.932	2939	2.537	2626	2644	2658	41.241	40928	41708	41186
Qersh	2.428	2.461	2.482	2510	2.120	2203	2237	2255	19.210	19681	20471	22050
Nektarin a/Pjeshkë	1.347	1.365	1.401	1429	1.229	1243	1267	1281	19.472	19884	20392	20612
Gështenja	0	2.478	2.484	2492	0	2406	2407	2408	0	5846	5616	5091

Ndërkaq të dhëna mbi ullirin veçanërisht kemi tabelën 2 me të dhëna si numri i rrënjëve, prodhimi dhe rendimenti (2015-2021).

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Gjithsej (000 rrënjë)	9,225	9,608	9,786	10,008	10,288	10,532	10,746
Në prodhim (000 rrënjë)	6,332	6,643	7,442	7,798	8,226	8,616	8,827
Rendimenti (kg/rrënjë)	12	15	14	15	12	15	12
Prodhim (000 ton)	96	99	108	118	98	132	110

Ndikimi kryesor në rritjen dhe prodhimin e fidanëve dhe frutave nga drufrutorët mbetet klima. Ndryshimet klimatike përbejnë shqetësimin kryesor kur vjen fjala jo vetëm në bujqësi por në tërësi natyra e si pasojë njeriu, kafshët etj. Erozioni mund të përkufizohet si konsumimi i sipërfaqes së tokës nga forcat fizike të tilla si reshjet, uji i rrjedhshëm, era, akulli, ndryshimi i temperaturës, graviteti ose agjentë të tjerë natyrorë ose antropogjenë që gërryejnë, shpëputin dhe largojnë dheun ose materialin gjeologjik nga një pikë e tutje. sipërfaqja e tokës të depozitohet diku tjetër. Kur përdoret në kontekstin e presioneve në tokë, erozioni i referohet humbjes së përsheptuar të tokës si rezultat i aktivitetit antropogjen, mbi normat e pranueshme të formimit natyror të tokës. Humbja e tokës çon në një rënie të përmbajtjes së lëndës organike dhe lëndëve ushqyese, në prishjen e strukturës së tokës, në një reduktim të ujit të depozituar të tokës në dispozicion, gjë që mund të çojë në një rrezik

³ Urdhër Nr. 578, datë 2.12.2022 “Për miratimin e Planit të Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, 2022–2032”.

të shtuar të përmytjeve dhe rrëshqitjeve të dheut në zonat ngjitur. Cikli i lëndëve ushqyese dhe i karbonit mund të ndryshohet ndjeshëm nga mobilizimi dhe depozitimi i tokës, pasi toka e gërryer mund të humbasë 75% - 80% të përmbajtjes së saj të karbonit, me rrjedhim të çlirimit të karbonit në atmosferë. Erozioni i tokës ndikon fuqishëm në mjedis dhe ka kosto të larta ekonomike; për të zbutur këto efekte, kërkohen strategji të ruajtjes së tokës dhe ujit⁴. Ekonomia shqiptare ka përfituar prej stabilitetit makroekonomik dhe reformave ekonomike, të cilat kanë siguruar mundësi zhvillimi për sektorin privat dhe nxitjen e investimeve. Shqipëria është një vend me një nivel mesatar të ardhurash, me të ardhura vjetore për frymë në vlerën 484,000 lekë ose 3,457 euro dhe me rritje ekonomike të qëndrueshme. Rritja ekonomike në vitin 2013 në terma realë ishte 1.39% dhe 2.02 në vitin 2014. Më 2014-n, sektori bujqësor (bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi) zinte rreth 20% të GDP-së, ndërsa vlera bruto e shtuar në sektorin bujqësor kapi një vlerë prej 280,036 milionë lekësh, duke kontribuar me 0.44 pikë përqindje në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto dhe duke shënuar një rritje prej 5.6% krahasuar me vitin 2013.

Si vend kandidat i BE-së, Shqipëria ka nisur procesin e transpozimit të direktivave të BE-së në legjislacionin e saj kombëtar. Në fushën e mbrojtjes së mjedisve ujore, fokusi është në krijimin e një kuadri të ri legjislativ dhe institucional për mbrojtjen e natyrës duke marrë parasysh Direktivën e Këshillit 92/43/KEE për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër. Në Shqipëri, mbrojtja e tyre në parim garantohet nëpërmjet ligjit nr. 10431, datë 14.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 5 i të cilit përcakton se “Ruajtja e diversitetit biologjik është një nga elementet kryesore mjedisore”.

Gjithashtu, mbrojtja e natyrës mbështetet nga një sërë aktesh ligjore, ndër të cilat mund të përmendim: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, 'Për mbrojtjen e biodiversitetit', i ndryshuar me Ligjin nr. 68/2014, si dhe Ligjin nr. 81/2017, 'Për zonat e mbrojtura', ndër të tjera.

Për të garantuar zbatimin e këtyre ligjeve, janë nxjerrë një sërë aktesh nënligjore për të plotësuar bazën ligjore për elemente të veçantë të mbrojtjes së natyrës. Kështu, VKM nr. 31, datë 20.1.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike të Mbrojtjes së Mjedisit (DPSMM), identifikon qartë fushat kryesore të punës, në veçanti: rritjen e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura, hartimin e Planeve të Menaxhimit dhe zbatimin e tyre; plotësimin e kuadrit ligjor, në përputhje me ligjet e BE-së për mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe ekosistemeve etj⁵.

Rritja ekonomike në sektorin e bujqësisë gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri është ndikuar kryesisht nga faktorët tradicionalë të prodhimit – toka, puna dhe kapitali – të cilët, megjithatë, nuk kanë njohur ndryshime domethënëse në strukturë apo cilësi. Stabiliteti

⁴ Treguesit janë vlerësime të parashikuara dhe jo vlera reale. Ato rrjedhin nga një version i përmirësuar i modelit të Ekuacionit Universal të Rishikuar të Humbjes së Tokës i zhvilluar për të vlerësuar erozionin e tokës nga uji në një shkallë rajonale. Struktura e modelit është përshtatur për të marrë parasysh planifikimin e ruajtjes, shkallën e erozionit të inventarit dhe vlerësimin e shpërndarjes së sedimentit në bazë të njohurive të pranuar shkencore dhe gjykimit teknik.

Në këtë vlerësim, modeli bazë RUSLE është përshtatur përmes përmirësimit të cilësisë së faktorëve të hyrjes. Burimi, faqja zyrtare e BE-së:

https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Agri-environmental_indicator_-_soil_erosion.

⁵ Urdhër Nr. 578, datë 2.12.2022 “Për miratimin e Planit të Veprimit për Përdorimin e Qëndrueshëm të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, 2022 - 2032”.

makroekonomik dhe liberalizimi ekonomik çoi në rishpërndarjen e burimeve nga sektorët më pak përfitues (drithërat) tek aktivitetet më me leverdi (pemëtaria, perimet dhe mbarështimi i blegtorisë), të cilat i mundësuan bujqësisë rritjen e mëtejshme me më pak investime. Struktura e tokës bujqësore private dhe situata aktuale e fragmentimit të saj. Shpërndarja e tokës bujqësore gjatë reformës së tokës në fillim të viteve '90, krijoi një strukturë sipërfaqesh të vogla e të fragmentuara.

Sipas Vjetarit Statistikor të MBZHR (2011), në Shqipëri figurojnë rreth 388,697 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familje fermere është rreth 1.26 ha të ndara në 4.7 parcela me një sipërfaqe mesatare për parcelë prej 0.27 ha. Referuar të dhënave të INSTAT-it, qershor 2014, në Shqipëri rezultojnë rreth 352.315 familje fermere, ku sipërfaqja mesatare e tokës në pronësi të çdo familje fermere është rreth 1.16 ha. Rreth 46% e fermave kanë një sipërfaqe nën 1 ha, ndërsa 86% e tyre nën 2 ha. Sipërfaqja totale e tokës bujqësore prej 696,000 ha përfshin 24% të të gjithë territorit të vendit.

Nga kjo sipërfaqe, rreth 562,000 ha ose 80% është në pronësi private dhe 134,000 ha ose 20% është në pronësi publike (shtetërore). Megjithatë, për shkak të ndërtimeve informale, zgjerimit të zonave urbane dhe tjetërsimit për investime publike fond i tokës bujqësore është zvogëluar dhe është në proces puna për saktësimin dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin kadastral. Nga sipërfaqja prej rreth 134,000 ha tokë bujqësore në pronësi shtetërore, 109,500 ha janë toka të pandara të ish-kooperativave bujqësore - objekt i Ligjit Nr. 7501, miratuar më 1991 - tokë, që është refuzuar nga familjet rurale për shkak të pjellorisë natyrale relativisht të ulët, distancës së largët nga qendrat e banuara, mungesës së infrastrukturës (rrugë, kanale ujitëse), pjerrësisë dhe vendndodhjes përgjithësisht në zonat kodrinore-malore. Nga sipërfaqja e tokave të pandara, e cila është në administrim të bashkive për t'u dhënë me qira, 23,368 ha ka kaluar në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (VKM Nr. 770, datë 12.4.2014; Fletore Zyrtare Nr. 185, viti 2014). Në pronësi të shtetit përfshihen, gjithashtu, edhe rreth 25,000 ha tokë bujqësore, që ka qenë në pronësi të ish-fermave shtetërore, e pandarë për shkak të tejkallimit të normës së sipërfaqes së tokës për frymë (aktualisht në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural), që shërben si tokë për qiradhënie dhe për institucionet shtetërore në kuadër të kryerjes së detyrave të tyre institucionale. Struktura e tokës së kultivuar dominohej nga bimët e arave, pemët frutore, ullinjtë, agrumet dhe vreshtat⁶.

⁶ Vendim Nr. 700, datë 12.10.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri" fq. 1.

Nr No	Qarku Prefectures	Peme frutore Fruit	Ullinj gjithsej Total Olives	Ullinj tavoline Olives	Ulli për vaji Olive oil	Agrume Citrus	Rrush nga vreshti Vineyard grape	Rrush nga pjergulla Grape from pergola	Rrush gjithsej Total grape
1	Berat	25,229	12,860	7,880	4,980	3,779	10,500	5,520	16,020
2	Dibër	25,801	-	-	-	-	2,065	6,645	8,710
3	Durrës	15,260	7,286	338	6,948	1,844	11,345	4,420	15,765
4	Elbasan	40,504	24,138	1,506	22,633	2,249	19,067	12,012	31,079
5	Fier	36,313	37,700	2,364	35,336	10,010	30,102	9,075	39,176
6	Gjirokastrë	2,511	2,161	215	1,946	42	581	1,326	1,906
7	Korçë	74,605	-	-	-	-	7,051	5,237	12,288
8	Kukës	7,385	-	-	-	-	572	4,050	4,622
9	Lezhë	7,478	1,982	475	1,507	647	2,988	2,114	5,102
10	Shkodër	15,747	1,173	-	1,173	635	3,593	5,924	9,517
11	Tiranë	17,362	6,825	608	6,218	1,690	10,331	7,343	17,674
12	Vlorë	13,742	23,492	1,607	21,885	35,834	6,663	11,183	17,846
Gjithsej / Total		281,936	117,618	14,992	102,626	56,729	104,857	74,848	179,705

Tabela më lart është për drufrutorët dhe paraqet të dhënat e vitit 2023. Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit⁷.

Ulliri është një nga drufrutorët më të rëndësishëm për vendin tonë, me traditë të hershme kultivimi dhe vlera të shumta ekonomike, ushqimore dhe kulturore. Ai përfaqëson një komponent të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare, veçanërisht në zonat mesdhetare, ku kushtet agroklimatike janë të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e tij. Ndër të tjera, cilësia dhe karakteristikat ushqimore të vajit të ullirit janë rezultat i një sërë faktorësh, ndër të cilët një nga më përcaktuesit është kultivari i ullirit. Zgjedhja e kultivarit ndikon ndjeshëm jo vetëm në rendimentin e vajit, por edhe në përbërjen kimike dhe vlerat funksionale të tij. Në vijim, paraqitet një analizë e rolit që luan kultivari në këto aspekte. Kultivari i ullirit ndikon në cilësinë dhe sasinë e vajit të ullirit. Mesatarja e përmbajtjes së vajit në fryt në pjekurinë e plotë luhet nga 10 deri në 25% të peshës së freskët. Sasia e antioksidantëve natyrorë në vajin e ullirit ndryshon kryesisht në varësi të kultivarit. Kultivarët autoktonë, ashtu si në vende të tjera të Pellgun Mesdhetar, nuk janë thjesht varietete apo kultivarë të pastër, por popullata me variabilitet të gjerë gjenetik, shumë shpesh të përzgjedhura me mënyra empirike nga bujqit brez pas brezi. Kushtet pedoklimatike dhe natyra e terrenit kodrinor e malor në vendin tonë, kanë bërë që pavarësisht territorit të vogël, të kemi larmi të madhe të ekotipeve autoktonë të ullirit me karakteristika të dallueshme e të qëndrueshme. Disa prej tyre u janë përshtatur kushteve të veçanta të mikroklimës dhe përdorimi i tyre për mbjelljet e reja është i rëndësishëm për të garantuar produktivitetin e ullishtës, sidomos në këto zona dhe në zona ekstreme të kultivimit. Por rëndësia më e madhe e ekotipeve dhe germoplazmës së ullirit në përgjithësi, është se ato janë burim për punën përmirësuese gjenetike të kultivarëve nëpërmjet metodave klasike (seleksionim klonal, kryqëzime, etj.) dhe sidomos të kombinuara me metoda moderne gjenetiko- molekulare.

⁷ Burimi “Instat” ëëë.instat.gov.al. Të dhëna nga viti 2024.

Kultivarët autoktonë, ashtu si në vende të tjera të Pellgun Mesdhetar, nuk janë thjesht varietete apo kultivarë të pastër, por popullata me variabilitet të gjerë gjenetik, shumë shpesh të përzgjedhura me mënyra empirike nga bujqit brez pas brezi. Ruajtja dhe studimi i resurseve gjenetike janë të domosdoshëm nga një anë për të shpëtuar pasurinë gjenetike dhe nga ana tjetër për të kryer përmirësim gjenetik të kultivarëve më të rëndësishëm nëpërmjet metodave klasike (seleksionim klonal, kryqëzime, etj.) dhe sidomos me metoda moderne gjenetiko molekulare⁸. Mund të përmendim këtu si shembull *kultivarin autokton të zonës së Tiranës*, i cili është i shpërndarë në ullishtet e kësaj zone dhe nuk është i përhapur jashtë vatrës së tij të origjinë. *Kultivar autokton i zonës së Vlorës* me emërtim nga fshati Kaninë, i përzgjedhur prej shekujsh, përbën një popullatë me ndryshueshmëri morfologjike, ku dallohen forma me kurorë globoze dhe vertikale. *Kultivar autokton në zonën kodrinore Berat - Fier - Mallakastër*, është i shpërndarë dhe i rrallë nëpër ullishte. *Kultivar autokton në zonën e Krujës*, është i shpërndarë, popullatë e pa përpunuar nga seleksionimi. *Kultivar autokton me origjinë nga fshati Kallmeti i Lezhës*, mbizotëron në zonën e vet dhe është i përhapur edhe në Shkodër etj.

Disa nga aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet ky sektor janë siç vijon:

➤ **Ligje**

- Ligji Nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”;
- Ligji Nr. 8318, datë 1.4.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”.

➤ **Vendime të Këshillit të Ministrave**

- Vendimi Nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, e ndryshuar;
- Vendimi Nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”;
- Vendimi Nr. 537, datë 25.7.2019 “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të laboratorëve të diagnostifikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve”;
- Vendimi Nr. 240, datë 27.3.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutorë”.

➤ **Akte të tjera nënligjore**

- Udhëzimi Nr. 107, datë 2.12.2002 “Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor”;
- Udhëzimi Nr. 11, datë 10.5.2021, “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, të freskëta dhe/ose fara të përpunuara”.

⁸ Programi për modernizimin e bujqësisë (PROMAS) - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Shqipëri Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Dektorit të Ullirit në Shqipëri – ASDO”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Mospërputhja e kuadrit ligjor në fuqi me zhvillimet e ndodhura ndër vite në sektorin e bujqësisë, veçanërisht në drejtim të kultivimit dhe menaxhimit të drufrutorëve, ka krijuar boshllëqe rregullatore që pengojnë përshtatjen e sektorit me nevojat aktuale teknike dhe ekonomike. Ligji ekzistues nuk është përditësuar për të pasqyruar ndryshimet në politikat bujqësore, në strukturat institucionale dhe në nevojat bashkëkohore të fermerëve, çka ka sjellë një mospërputhje të theksuar midis kuadrit ligjor dhe realitetit në terren. Kjo mungesë koherence ka ndikuar në zbatueshmërinë e ligjit dhe ka kufizuar mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt tregut në sektorin e drufrutorëve. Përveç problematikave që lidhen me rrezikun ndaj sektorit të drufrutorëve, veçanërisht ullirit, si pasojë e zhvillimeve territoriale, pasigurisë së sektorit dhe pasigurisë së investimeve nga fermerët, do të trajtohet edhe përditësimi i emërtesave të institucioneve të varësisë, të cilat kanë kaluar në procese reformimi dhe ristrukturimi. Moskoherenca e identifikuar ligjore përbën një problem serioz që cënon potencialin e zhvillimit afatgjatë të sektorit bujqësor, duke ndikuar negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e kulturave drufrutore, të cilat kanë karakteristika specifike dhe kërkojnë një qasje të dedikuar dhe të vazhdueshme.

Konkretisht, drufrutorët si ullinjët, fiku, qershia, pjeshka etj., janë kultura shumëvjeçare që kërkojnë mbrojtje të posaçme për shkak të kohës së gjatë të prodhimit dhe kontributit të tyre ekonomik, mjedisor dhe kulturor në territor. Megjithatë, zhvillimet urbane, ndërtimet pa planifikim dhe mungesa e një kornize ligjore të qartë që garanton mbrojtjen e këtyre kulturave kanë sjellë pasoja konkrete si dëmtim të plantacioneve ekzistuese, shndërrim e statusit të tokës bujqësore në statuse të tjera si dhe humbje të investimeve afatgjata të fermerëve.

Shkaku i problematikës: Shkaku kryesor i kësaj problematike qëndron në mungesën e përditësimit dhe harmonizimit të legjislacionit aktual me ndryshimet strukturore, mjedisore dhe socio-ekonomike që kanë ndodhur në sektorin e bujqësisë. Ligji në fuqi nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të mjaftueshme rëndësinë që kanë drufrutorët në zhvillimin e qëndrueshëm rural, nuk parashikon masa të qarta mbrojtëse për to përballë ndërhyrjeve në territor, dhe nuk garanton integrimin e tyre në politikat zhvillimore afatgjata. Mungesa e një qasjeje të integruar ndërmjet zhvillimit të territorit dhe mbrojtjes së trashëgimisë bujqësore ka krijuar një boshllëk institucional dhe ligjor, ku drufrutorët mbeten të pambrojtur ndaj presioneve të tregut, urbanizimit dhe mungesës së planifikimit.

Në vijim evidentojmë disa prej problematikave: Ligji Nr. 7929/1995 “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, në formën e tij aktuale, është miratuar në vitin 1995 duke e bërë të nevojshëm harmonizimin e tij me legjislacionin e ri të miratuar pas tij. Duke patur në vëmendje kohën e hershme të miratimit të tij është krijuar një boshllëk rregullator i cili ka ndikuar negativisht

në mbrojtjen, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kulturave drufrutore në vend. Ndryshimet ligjore që janë bërë në vite në sektorë të ndërlidhur si planifikimi i territorit, zhvillimi rural, mjedisi, siguria ushqimore apo administrimi i pronës, nuk janë reflektuar në përmbajtjen e këtij ligji, duke krijuar mospërputhje ndërmjet dispozitave të tij dhe kuadrit ligjor të sotëm. Kjo mospërputhje pengon zbatimin efektiv të masave mbrojtëse dhe zhvillimore për drufrutorët, çënon të drejtat e fermerëve dhe investorëve bujqësorë, si dhe e vështirëson integrimin e objektivave të këtij ligji në politikat e përgjithshme të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Shkaku i problematikës: 1. Shkaku kryesor lidhet me mosrishikimin në kohë të ligjit dhe mungesën e një mekanizmi të rregullt për përditësimin e tij në përputhje me zhvillimet ligjore, institucionale dhe teknike. Për më tepër, mungesa e një analize gjithëpërfshirëse të ndikimit të ligjit ekzistues ka bërë që ai të mos i përgjigjet më nevojave aktuale të sektorit bujqësor, veçanërisht në fushën e drufrutorëve, të cilët kërkojnë mbrojtje të posaçme për shkak të natyrës së tyre shumëvjeçare dhe kontributit që japin në zhvillimin rural, mjedisor dhe ekonomik.

2. Një ndër pengesat kryesore për zbatimin efektiv të Ligjit Nr. 792/1995 është mospërputhja e emërtesave të institucioneve të përmendura në ligj me strukturat aktuale administrative. Shumë prej institucioneve të cilat janë përcaktuar si përgjegjëse për zbatimin e ligjit janë tashmë të shkrira, të riorganizuara ose nuk ekzistojnë më në formën ligjore të përmendur, çka sjell paqartësi institucionale dhe vështirësi në zbatimin praktik të dispozitave ligjore. Kjo situatë komprometon funksionimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe kontrollit për drufrutorët, duke shkaktuar ngërçe në ndarjen e qartë të përgjegjësiave, mungesë koordinimi ndërinstitutional dhe pamundësi për të kërkuar llogaridhënie. Për rrjedhojë, ligji rezulton i pazbatueshëm në disa aspekte të tij, pavarësisht vullnetit për ta zbatuar.

3. Aktualisht mungon një kuadër i qartë ligjor dhe procedural që rregullon procesin e ndryshimit të ekonomisë bujqësore, përkatësisht kalimin nga një sistem prodhimi (p.sh. pemëtari) në një tjetër (p.sh. kultura të tjera bujqësore), si dhe përshtatjen e kategorisë së tokës bujqësore me përdorimin aktual të saj, si arë, ullishte apo vresht. Kjo mospërputhje sjell pasiguri ligjore për fermerët, vështirëson regjistrimin dhe klasifikimin e saktë të tokës në dokumentet zyrtare dhe kufizon planifikimin e qëndrueshëm të përdorimit të tokës nga autoritetet dhe përdoruesit e saj. Për pasojë, ndryshimet faktike në terren nuk pasqyrohen në mënyrë zyrtare, duke krijuar moskoherencë midis realitetit agrar dhe regjistrimeve kadastrale apo statistikave zyrtare. Kjo ndikon negativisht në politikat e mbështetjes bujqësore, në saktësinë e planeve zhvillimore, si dhe në aftësinë për të përfituar nga subvencionet apo projektet zhvillimore që kërkojnë të dhëna të sakta mbi përdorimin e tokës.

4. Në mungesë të një mekanizmi të qartë ligjor dhe teknik, ruajtja e fondit të rrënjëve të ullirit është e rrezikuar në rastet kur kërkohet zhvendosja e tyre për shkak të ndërhyrjeve të planifikuara në territor, siç janë ndërtimet apo zhvillimet infrastrukturore të miratuara me instrumenta zyrtarë të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Ullinjët përfaqësojnë një pasuri shumëvjeçare me vlerë të lartë agrare, kulturore dhe mjedisore, por në praktikat aktuale të zhvillimit territorial, ata shpesh trajtohen si pengesë e zhvillimit, dhe jo si pasuri që duhet ruajtur dhe menaxhuar me kujdes. Mungesa e një procedure të detajuar për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit në mënyrë të kontrolluar dhe të dokumentuar e bën të

vështirë ruajtjen e qëndrueshme të këtij fondi biologjik dhe ekonomik, duke sjellë humbje të pakthyeshme në shumë raste.

5. Aktualisht, mungon një bazë ligjore e konsoliduar dhe e qartë që të rregullojë prerjen e pemëtoreve në rastet kur fermeri vendos të ndryshojë llojin e kulturës bujqësore, pa ndryshuar destinacionin e tokës, e cila mbetet për përdorim bujqësor. Kjo mungesë rregullimi sjell pasiguri ligjore për fermerët, të cilët në kushte tregu të paqëndrueshme janë të detyruar të përshtasin aktivitetin e tyre për të ruajtur qëndrueshmërinë ekonomike. Ligji në fuqi Nr. 7929/1995, nuk jep udhëzime të plota për këtë situatë, duke bërë një ndarje të përgjithshme mes pemëtoreve dhe ullishteve, pa e trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e prerjes së pemëve për qëllime bujqësore, siç është ndryshimi i kultivarëve apo zhvendosja e pemëtoreve në një pozicion më të përshtatshëm. Kjo sjell vështirësi në praktikë për autoritetet vendore dhe strukturat mbikëqyrëse, të cilat nuk kanë një bazë të saktë për të miratuar ose refuzuar kërkesat për prerje, si dhe krijon paqartësi për fermerët, të cilët rrezikojnë të penalizohen edhe nëse janë duke ndjekur praktika të ligjshme të menaxhimit agrar.

6. Një nga sfidat më të mëdha që përballen sot bujqësia shqiptare është mungesa e një mekanizmi funksional për transferimin e njohurive dhe inovacionit tek fermerët, çka përbën një pengesë serioze për modernizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Edhe pse në vend ekziston një bazë e rëndësishme e burimeve të dijes, përfshirë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB), Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), si dhe universitetet bujqësore, kjo dije nuk rezulton të arrijë në mënyrë maksimale dhe të drejtpërdrejtë në sistemin e këshillimit bujqësor, duke prodhuar mosfunksionim efektiv në raport me prodhimin të njohurive dhe përdorimit të tyre në praktikë nga fermerët. Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB), si hallka kryesore për ofrimin e këshillimit dhe trajnimit të fermerëve, nuk është aktualisht i integruar maksimalisht me institucionet që prodhojnë dije dhe inovacion.

Në analizën e problematikave që qëndrojnë në themel të shqyrtimit për ndryshime të mundshme, vihet re se kuadri aktual ligjor nuk është në përputhje me zhvillimet që kanë ndodhur ndër vite në sektorin e bujqësisë, veçanërisht në kultivimin dhe menaxhimin e drufrutorëve.

Kjo mospërputhje lidhet me mungesën e përditësimeve të nevojshme që duhet të reflektonin ndryshimet në politikat bujqësore, në strukturat institucionale dhe në nevojat bashkëkohore të fermerëve. Si pasojë, ka një hendek të dukshëm midis normës ligjore dhe realitetit në terren, çka ka ndikuar negativisht në zbatueshmërinë e ligjit dhe ka kufizuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të orientuar drejt tregut të këtij sektori.

Përveç kësaj, sektorit të drufrutorëve – dhe veçanërisht kultivimit të ullirit – i kanosen rreziqe të lidhura me zhvillimet territoriale, pasigurinë e investimeve dhe mungesën e mbështetjes së qëndrueshme për fermerët. Një tjetër aspekt që do të trajtohet është përditësimi i emërtesave të institucioneve të varësisë, të cilat ndër vite kanë kaluar në procese reformimi dhe ristrukturimi institucional.

Ekstensionistët publikë ndodh që nuk reflektojnë rrishtë më të fundit në teknologjinë bujqësore, praktikat e qëndrueshme, ose zgjidhjet ndaj sfidave klimatike dhe tregut.

Shkaku i problematikës: Shkaku kryesor lidhet me mungesën e një strukture të mirëkoordinuar dhe institucionale që lidh prodhimin shkencor dhe kërkimor me aplikimin praktik në terren.

Kjo vjen si pasojë e disa faktorëve:

- burime njerëzore dhe financiare të kufizuara në shërbimin e ekstensionit;
- trajnime të pamjaftueshme për ekstensionistët publikë;
- niveli i ulët i digjitalizimit dhe mungesë e një platforme të përbashkët të transferimit të njohurive;
- pjesëmarrje e dobët e fermerëve në rrjete inovative dhe struktura bashkëpunimi.

Ky izolim i qendrave të dijes nga praktika në terren çon në një bujqësi të fragmentuar, me produktivitet të ulët, mangësi në adoptimin e praktikave të reja dhe me kapacitet të kufizuar për të përballuar sfidat e tregut dhe ndryshimeve klimatike.

Rëndësia që paraqesin drufrutorët në bujqësi sjell nevojën për zgjidhjen e disa problematikave siç janë afektimi nga zhvillimet e ndryshme të territorit dhe rreziku që paraqet kjo për drufrutorët, veçanërisht disa lloje drufrutorësh siç janë ullinjtë kanë jetëgjatësi shumë vjeçare. Megjithatë problematikat e sipërcituara prekin të gjithë drufrutorët dhe tokat bujqësore, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Problematikat e evidentuara më lart kanë kryesisht natyrë rregullatore.

Grupet e prekura nga ky problem janë:

- *Operatorët e bizneseve* të frutave që vijnë nga drufrutorët, tregtarët e fidanëve etj.
- *Qeveria*;
- *Fermerët kultivues*;
- *Komuniteti dhe shoqëria civile*.

o **Qeveria**- Ka vështirësi në zhvillimin e politikave që inkurajojnë kooperimin dhe bashkëpunimin, duke e vështirësuar implementimin e strategjive për zhvillim rural të cilat impaktojnë ekonominë, tregtinë, zhvillimin e bujqësisë, vënien në efikasitet e tokave bujqësore rritjen e investimeve dhe të prodhimit të frutave që vijnë nga drufrutorët.

o **Fermerët**- të cilët kanë objekt të tyrin kultivimin e drufrutorëve dështojnë të maksimizojnë të ardhurat dhe përballen me sfida të menaxhimit të produkteve dhe konkurrencës si dhe rrezikojnë investimin shumëvjeçar⁹.

o **Komuniteti dhe shoqëria civile** - Përdorimi intensiv dhe jo-adekuat i tokave bujqësore ka çuar në degradimin e mjedisit, ndotjen e ujit dhe ajrit, si dhe erozionin e tokës. Rrezikimi i pemëve nga zhvillimet dhe zgjerimet e qyteteve e zonave të tjera zhvilluese është një shqetësim i vazhdueshëm serioz me ndikim direkt në mjedis, pasoja të natyrës klimatike dhe cilësinë e jetesës së njëriut dhe kafshëve si tërësi. Mungesa e pemësisë çon ndotjen e ajrit, rritjen e temperaturave pasi pemët ofrojnë hije, cenohet cilësia e jetesës së

⁹ Ulliri është bimë shumë vjeçare, konsiderohet shekullore me mbi 100 vite jetëgjatësi. Po kështu edhe lloje të tjera të drufrutorëve kanë jetëgjatësi të gjatë 20-30 vite si dhe kërkojnë investime të vazhdueshme për të dhënë prodhimtarinë e kërkuar nga tregu.

kafshëve apo gjallesave të tjera të cilat jetojnë në gjelbrim por konkretisht rrezikimi i drufrutorëve ndikon edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në interesin dhe të ardhurat e fermerit. Pemët drufrutore kërkojnë investim të vazhdueshëm dhe të zgjatur në kohë, shpesh me dekada, dhe kur kjo vihet në diskutim si shkak i zhvillimeve territoriale, për fermerin është një rëndesë e madhe me pasoja tejet negative për të.

o **Operatorët e bizneseve**- të cilët mund të jenë tregtarë, grumbullues, eksportues të prodhimeve të drufrutorëve, apo tregtues të plehërave kimikë/organikë të cilët përdoren për shëndetin e tyre etj. ~~ndikohen nga risitë e këtij projekligji~~ pasi aktualisht drufrutorët rrezikohen nga prerjet në raste të caktuara siç janë përfundimi i kontratës së qiramarrjes së tokës bujqësore apo zhvillimet e territorit etj. Kjo ka sjellë ndikime negative në këtë sektor të bujqësisë lidhur me prodhimin, stabilitetin në bujqësi etj. Prodhimi i fidanave veçanërisht i ullirit është kompleks, pasi aktiviteti i fidanishteve nuk mund të konceptohet i ndarë nga kërkesat e tregut të prodhuesve të ullirit. OB hasin në humbje të të ardhurave, humbje e investimeve të cilat janë ushtruar në afate të gjata në kohë kjo si pasojë e natyrës së vecantë të aktivitetit të tyre bujqësor, tregu ka më pak prodhim frutor, cilësi jo e mirë e produkteve bujqësore, mungesë stabiliteti në bujqësi, mungesë besimi nga investitorët në këtë fushë qofshin të huaj apo të brendshëm etj.

Problemi trajtohet vetëm përmes ndryshimit të politikave duke përditësuar ligjin me aspekte të ndjeshme në këtë fushë të bujqësisë siç është ai i kultivimit të drufrutorëve, mbrojtja e tyre, sidomos ulliri i cili është bimë shumëvjeçare, nga ndikimet që vijnë si pasojë e zhvillimeve në kohë.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*

Arsyeja e ndërhyrjes së qeverisë nëpërmjet një nisme, është përmirësimi i kuadrit rregullator në fuqi, harmonizimi me ligjet e tjera të miratuara në vazhdimësi, si dhe mbrojtja e fermerëve të cilët kanë si objekt të veprimtarisë së tyre kultivimin e drufrutorëve, ullirin, nga ndikimet e jashtme që i afektojnë ata siç janë zhvillimet e territorit etj. Nevoja për përditësimin e legjislacionit kuptohet më qartë nëse marrim parasysh ritmet e shpejta me të cilat po avancohet sektori i bujqësisë, veçanërisht në drejtim të përdorimit të inovacioneve – si në përmirësimin shkencor të produkteve bujqësore, ashtu edhe në zhvillimin e teknologjive të mjeteve dhe pajisjeve bujqësore. Duke qenë një sektor me rëndësi strategjike për çdo shtet, Shqipëria ka potencialin të adoptojë praktika më të avancuara se modelet tradicionale të trajnimit dhe mbështetjes për fermerët. Inovacioni përbën shtyllën kryesore të ndryshimeve strukturore në bujqësi, duke orientuar zhvillimin e sektorit drejt modernizimit dhe përmirësimit të ndërlidhjeve me sektorë të tjerë mbështetës. Njohuritë e disponueshme të QTTB-ve, AREB-ve dhe universiteteve duhet të lidhen drejtpërdrejt me sistemin e këshillimit dhe t'u transferohen fermerëve. Ekstensionistët publikë nga Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) duhet të jenë më të lidhur me ofruesit e inovacionit dhe të njohurve. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar politika të vazhdueshme dhe mirëmenduara por edhe përafrime me rregulloret përkatëse të BE-së në fushën e bimëve, përdorimit të plehërave e pesticideve në bujqësi, kultivimin e drufrutorëve, dhënien me qira të tokave bujqësore etj. duke pasuruar kështu bazën ligjore solide dhe eficiente mbi të cilën mbështetet një nga fushat më kryesore të vendit që është bujqësia. Fushat e sipërpërmendura marrë si tërësi janë përmbledhje rregullash dhe normash

të cilat rregullojnë të gjithë zinxhirin duke filluar nga fara deri te produkti përfundimtar te konsumatori sipas parimit të BE-së “*Nga tryeza në tavolinë*”.

Kjo nismë është në përputhje me dokumentet e nivelit të lartë të Qeverisë si:

1. Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027;
2. Programi Qeverisë 2021-2025.
3. Vendimi Nr. 700, datë 12.10.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Konsolidimin e Tokës në Shqipëri”.

- *Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021/2027* është dokumenti politik, i cili ka parashikuar masa, objektiva, qëllime konkrete, të matshme dhe me afate të përcaktuara për ecurinë e bujqësisë sipas fushës së përgjegjësisë duke i kushtuar vëmendje çdo sektori pa prejashtim. Transformimi me ritme më të shpejta i prodhimit bujqësor, që është i nevojshëm për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme ushqimore kërkon një sektor bujqësor ekonomikisht performues dhe të qëndrueshëm, si edhe një sektor konkurrues të agropërpunimit. Sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore që trajtohen në kuadër të objektivit të përgjithshëm janë si për të përmirësuar mundësitë e aktivitetit në bujqësi, ashtu edhe për të gjeneruar mundësi të reja, si dhe për të konsoliduar tregjet ekzistuese dhe eksploruar tregje të reja, brenda dhe jashtë vendit për sektorin agroushqimor. Me synimin e rritjes së eksporteve, do të promovohet veçanërisht rritja e konkurrueshmërisë, duke përmirësuar nivelin e mekanizimit të fermave, duke rritur sipërfaqet e serrave, të pemëve frutore intensive, ullishtave dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, diversifikimi i produkteve bujqësore të kultivuara dhe shtimi i sipërfaqeve, të cilat kanë vlerë më të lartë të shtuar për operatorët e sektorit dhe ose kalojnë nëpërmjet përpunimit, si dhe nëpërmjet shtimit të blegtorisë së imët dhe rritjes së rendimentit për krerë në lopët e qumështit¹⁰. Gjatë këtyre viteve janë mbështetur dhe stimuluar ndryshimet në strukturën e mbjelljeve të produkteve bujqësore, në funksion të rritjes së prodhimit, zbatimit të standardeve të larta dhe plotësimin e kërkesave të tregjeve të brendshme dhe atij ndërkombëtar. Ndryshimet më të mëdha në strukturën e mbjelljeve kanë ndodhur kryesisht në zinxhirët e vlerës të perimeve, pemëve frutore, ullinjve, agrumeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, luleshtrydheve etj., jo vetëm për plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm, por edhe duke rritur në mënyrë të konsiderueshme edhe volumet e eksporteve¹¹.

- *Programi i Qeverisë 2021-2025* po kështu ka fokus të veçantë te bujqësia, me kërkesa dhe objektiva të qarta në fushën e bujqësisë jo vetëm për shkak të rëndësisë që bujqësia paraqet për vendin por edhe më gjerë. Në aspektin e përmbushjes së detyrimeve për anëtarësimin në BE bujqësia përgjigjet për 3 Kapituj të rëndësishëm që janë 11, 12 dhe 13, përmes raportimit periodik të vazhdueshëm pranë institucioneve kompetente në BE, në marrëdhënien laterale. Përkatësisht këta kapituj janë:

- Kapitulli 11- Bujqësia dhe Zhvillimi Rural;
- Kapitulli 12- Siguria Ushqimore, Politikat Veterinare dhe Fitosanitare;
- Kapitulli - 13 Peshkimi.

Konsolidimi i tokës është një problematikë, e cila është objekt diskutimi në mënyrë të vazhdueshme kjo për shkak të pengesës që sjell paqartësia e statusit juridik të tokës

¹⁰ SBZHRP fq.18.

¹¹ SBZHRP fq.10

bujqësore për zhvillimin e bujqësisë. Problematikat që lidhen me pronësinë e tokës, mbivendosjet e pronësisë, paqartësi mbi statusin juridik, proceset gjyqësore masive lidhur me pronësinë etj. përbëjnë pengesa shumë serioze lidhur me zhvillimin e bujqësisë kjo për shkak se toka bujqësore është parakusht për aplikimin për zhvillimin e një veprimtarie bujqësore pranë MBZHR-së. Konsolidimi dhe saktësia lidhur me statusin e tokës është objektiv shumë i rëndësishëm dhe për këtë është miratuar edhe Strategjia Kombëtare e Konsolidimit të Tokës në Shqipëri.

Arsyeja e ndërhyrjes së qeverisë, është investimi në mirëqënien e drufrutorëve veçanërisht ullirirt si bimë shumëvjeçare duke u kujdesur për pasurimin me risi dhe metoda inovatime kuadrin ligjor. Në këtë këndvështrim, duke marrë në konsideratë natyrën tepër të rëndësishme që ka toka bujqësore dhe mirëqënia e drufrutorëve në kontekst të prodhimit bujqësor propozohen ndryshimet në ligjin aktual në mënyrë që të arrihen objektivat e synuara.

Shfrytëzimi efikas i tokave bujqësore dhe mbrojtja e investimeve afatgjata në drufrutorë, është një sfidë komplekse që kërkon një qasje të integruar. Kjo qasje duhet të marrë parasysh faktorë teknikë, ekonomikë, socialë dhe mjedisorë. Këtu janë zbatuar disa strategji dhe konsiderata kyçe për të arritur këtë qëllim:

- përdorimi i teknologjive inovative në përshtatje e kuadrin ligjor me qëllimin e ruajtjes së mirëqënies së drufrutorëve;
- zgjedhja e përmirësimeve të përshtatshme për kushtet e tokës bujqësore me pjellori të ulët dhe që kanë tolerancë ndaj thatësirës ose kripës kur kjo është e nevojshme;
- kultivimi i kulturave me vlerë të lartë me qëllim sigurimin për kthime ekonomike të volitshme edhe nga tokat me pjellori të ulët;
- reduktimi i rrezikut të sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe për të diversifikuar burimet e të ardhurave;
- praktika të qëndrueshme bujqësore në bujqësinë organike për të minimizuar përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike dhe për të promovuar shëndetin e tokës dhe biodiversitetin si parim universal në bujqësi;
- zbatimin e praktikave të bujqësisë së konservimit si mbjellja e drejtpërdrejtë, mbulesa e tokës dhe rotacioni i kulturave për të reduktuar erozionin e tokës, për të përmirësuar strukturën e tokës dhe për të ruajtur ujin;
- zhvillimi i politikave që inkurajojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore me pjellori të ulët dhe që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit.

Bazuar në faktin se prodhimi i Bashkimit Evropian (BE) përfaqëson vetëm 1% të prodhimit global të akuakulturave dhe importon rreth 60% të saj, ekziston një potencial i madh për rritje dhe zhvillim në këtë fushë. Për të arritur këtë objektiv, synohen të ndërmerren disa hapa të rëndësishëm:

- investimet në teknologji të reja dhe zbatimin e metodave moderne me qëllim ruajtjen e mirëqënies së investimeve afatgjata në kultivimin e drufrutorëve mund të rrisë efikasitetin dhe cilësinë e prodhimit, duke e bërë më konkurrueshëm në tregun global;
- zhvillimi i produkteve me vlerë të shtuar duke u fokusuar në prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar, të cilat mund të rrisin eksportet dhe të fitojnë të ardhura më të mëdha;

- promovimi i prodhimit vendor dhe mbështetja e fermerëve e mund të ndihmojë në rritjen e prodhimit dhe eksporteve;
- forcimi i tregut të brendshëm mund të cojë në hapjen e tregjeve të reja dhe negociimi i marrëveshjeve tregtare mund të rrisë eksportet dhe të diversifikojë tregjet e shitjes;
- mbështetja dhe promovimi i prodhimeve lokale dhe të qëndrueshme duke vënë theksin në prodhimin lokal dhe të qëndrueshëm, duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një imazhi pozitiv për prodhimet e vendit duke ndihmuar kështu në rritjen e eksporteve.

Nëpërmjet këtyre hapave, mund të rritet realizimi i objektivave për rritjen e eksportit të produkteve bujqësore vëndase dhe të forcohet pozita e vendit në tregun global, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e të ardhurave.

Plani i zhvillimit të këtij sektori (përfshirë marketingun) synon të orientojë qartë linjat strategjike të zhvillimit të politikave dhe ndërhyrjeve në drejtim të:

1. rritjes së aftësisë konkurruese dhe promovimit të prodhimit bujqësor vendas në tregun vendas dhe të huaj;
2. rritjes së vlerës së produkteve dhe të ardhurave të fermerëve në Shqipëri;
3. përmirësimin e vazhdueshëm të teknologjive të prodhimit & informacionin e vlefshëm për to;
4. konsolidimin e magazinimit dhe shitjes me pakicë të produkteve;
5. rritjen e kërkesës për prodhuesit, përpunuesit në termat e arritjes së cilësisë, sigurisë, paketimit dhe standardeve të tjera për të kënaqur kërkesat e konsumatorëve për mbrojtje ligjore (siguria ushqimore).

Në vijim po rendisim të gjithë punën ekzistuese që është realizuar deri më tani.

Deri më tani, sektori i bujqësisë që synon rregullimin dhe zhvillimin e kultivimit të drufrutorëve është mbështetur në një kuadër ligjor të fragmentuar, i cili përfshin fusha të ndryshme, siç është edhe përdorimi me qira i tokave bujqësore shtetërore për qëllime kultivimi të këtyre bimëve.

MBZHR bashkëpunon edhe me Universitetin Bujqësor e Tiranës, i cili është angazhuar dhe ka zhvilluar disa ëorkshope me tematikë drufrutorët, sfidat në aspektin e përmbushjes së detyrimeve të tregut europian, certifikimin e fidanëve drufrutorë autoktonë në Shqipëri. Në fokus të këtyre takimeve ishin tematika lidhur me zhvillimet e fundit sot në botë të cilat sjellin ndikime të ndryshme duke përfshirë edhe resurset gjenetike të bimëve, të cilët po përballen me sfidat e ngushtimit të bazës gjenetike për shumë kultura kryesore dhe problematikat e ruajtjes dhe pasurimit të diversitetit gjenetik. Universiteti Bujqësor ka një ndikim të konsiderueshëm me programet e tij të studimit, ekspertizat dhe me Institutin e Resurseve Gjenetike të Bimëve, për modernizimin e sektorit të bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore në vend. Po ashtu, UBT ka drejtuar dhe vazhdon të drejtojë procese të transformimit rrënjësor të bujqësisë shqiptare përmes studimeve në nivel kombëtar të tilla si për ullirin, vreshtat, florën, faunën etj. duke i ofruar bujqësisë shqiptare kultivarë dhe hibride të sukseshëm që përdoren edhe sot.

Zbatimi i këtij ligji përfshin edhe pushtetin lokal, bashkitë, të cilët përmes drejtorive të bujqësisë brenda organizimit të tyre ushtrojnë kompetenca lidhur me zhvillimet e bujqësisë. Aktualisht, qeveria parashikon disa lehtësi për fermerët të cilët operojnë në këtë fushë të bujqësisë, konkretisht disa bashki kanë miratuar masa për lehtësimin nga taksat për tokat

bujqësore gjatë 5 viteve të para të shfrytëzimit të tyre për mbjellje drufrutorësh dhe shumë bashki kanë të parashikuar dhe mbajnë të dhëna veçanërisht për drufrutorët në strategjitë e tyre si Bashkia e Elbasanit, Tiranës¹² etj.

Objektivi i politikës¹³

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të politikës së këtij projektligji janë si më poshtë:

1. Përditësimi 100% i emërtesave dhe kompetencave të institucioneve përgjegjëse, menjëherë pas hyrjes në fuqi të projektligjit.
2. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore përmes rritjes me 10% të sipërfaqeve të mbjella me pemë drufrutorë, në krahasim me kulturat e tjera bujqësore, brenda një periudhe 5-vjeçare nga hyrja në fuqi e projektligjit.
3. Ruajtja e 10% të fondit të rrënjëve të ullirit përmes zhvendosjes së tyre, në rastet e lejuara nga planet e zhvillimit të territorit, brenda një afati 10-vjeçar nga hyrja në fuqi e projektligjit.
4. Garantimi i mbrojtjes së ullirit, koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimëve me vlera gjenetike, brenda një afati 6-mujor nga miratimi i projektligjit.
5. Vendosja e ndalimeve për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtjeje, menjëherë me miratimin e ndryshimeve ligjore.

Sigurimi i mbulimit të kostove të zhvendosjes së rrënjëve të ullirit, nga subjekti zhvillues/pronari ose nga buxheti i shtetit, sipas rastit të projektit, brenda një afati 12-mujor nga miratimi i ndryshimeve ligjore.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

Përshkruani opsionin e status quo-së.

- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të katër opsionet:

Opsioni 0 (rregullator) – (ruajtja e status quo-së); Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime ligjore duke nënkuptuar mosdhënien e një zgjidhjeje problematikave të evidentuara.

Avantazhet:

¹²<https://elbasani.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Strategjia-e-Zhvillimit-per-Territorin-e-Bashkise-Elbasan-1.pdf>; https://tirana.al/uploads/2023/12/20231215153606_draft-strategjia-e-zhvillimit-te-qendrueshem-te-bashkise-tirane-2023-2027.pdf.

¹³ Lidhur me impaktin që do ketë teknologjia në sektorin e bujqësisë vlen të përmendet që ky është një indikator makro dhe performaca e sektorit bujqësor në vlerë monetare llogaritet nga INSTAT, për të bërë një vlerësim të tillë do kërkohej një analizë ex ante dhe post ante i impaktit të teknologjisë, nëpërmejet studimeve sektoriale.

- Ruajtja e status quo-së ofron një ambient të qëndrueshëm për fermerët aktorët e tjerë në zinxhirin e zbatimit të këtij ligji, evitohet pasiguria që vjen si shkak i ndryshimeve ligjore, vonesa si pasojë e përshtatjes me rrishtë ligjore etj.
- Kosto financiare: me ruajtjen e gjëndjes aktuale bëhet shmangia e shpenzimeve eventuale që ndodh në rastet e rishikimeve ligjore apo dhe procese të reja miratimi.

Disavantazhet:

- Problemet e shumta të evidentuara përgjatë procesit do të vazhdojnë të ndikojnë negativisht në sektorin e bujqësisë pa adresuar boshllëkun ligjor, si dhe nuk trajtohen çështjet e rëndësishme siç janë fragmentarizimi i tokës dhe degradimi i mjedisit.
- Krijohen pengesa për zbatimin e praktikave të mira, teknikave dhe metodave inovative e teknologjive në bujqësi, duke e bërë sektorin të pazhvilluar dhe joefikas.
- Nuk plotësohen kërkesat e BE-së në përmbushjen e synimeve të përbashkëta për anëtarësim përmes përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire* e BE-së.

Opsioni 1 (rregullator): Miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual Ligjin Nr. 7929, datë 11.5.1995, "Për mbrojtjen e drufrutorëve", nuk është opsioni i përshtatshëm, nuk trajton dhe zgjidh një sërë çështjesh në kohë duke mos dhënë rezultatet e duhura.

Avantazhet:

- Miratimi i një ligji të ri mund të sjellë një frymë të re dhe të nxisë besimin te fermerët dhe investitorët.
- Një ligj i ri mund të trajtojë duke dhënë zgjidhje dhe ofruar trajtim më të detajuar të drejtave dhe detyrimeve të hallkave institucionale të zbatimit të tij.

Disavantazhet:

- Miratimi i një ligji të ri mund të krijojë një periudhë pasigurie për fermerët, derisa të implementohet ligji i ri me pasojë jo vetëm në veprimtarinë e tyre bujqësore por edhe në të ardhurat që ata sigurojnë përmes saj.
- Vonesa në zgjidhjen e problematikave në kohë. Hartimi i ligjeve të reja kërkon një analizë të thellë dhe konsultime me palët e interesuara, si fermerët, ekspertët e sektorit dhe organizatat civile proces ky që ka efekte negative p.sh vonesa apo edhe vijimi i problematikave aktuale.
- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri paraqet kosto të larta në drejtim të burimeve njerezore dhe kohës së kërkuar prej tyre në këtë proces.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i Ligjit Nr. 7929, datë 11.5.1995, 'Për mbrojtjen e drufrutorëve', i cili rregullon disa çështje në fushën e mbrojtjes së drufrutorëve dhe i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1995. Me përditësimin e tij arrihen në mënyrë të kënaqshme objektivat, në kohë dhe me efikasitet të lartë në një linjë me zhvillimet dhe nevojat aktuale.

Avantazhet e këtij opsioni janë:

- Koha e nevojshme për hartimin dhe miratimin e ndryshimeve në ligj, krahasuar me miratimin e një ligji të ri është shumë më e madhe se koha që kërkon ndryshimi në një ligjin aktual duke përbërë kështu një avantazh. Ndërhyrja për shmangien e

problematikave do të jetë më e shpejte dhe efektive pasi ndryshimet që propozohen nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit në fuqi.

- Gjithashtu, ndryshimi i ligjit në fuqi nuk paraqet kosto financiare në drejtim të burimeve njerëzore të kërkuara.
- Evitimi i situatës se për ushtrimin e detyrave të përcaktuara në ligj nuk ka institucione që i zbatojnë ato. Me përcaktimin e institucioneve përgjegjëse bëhet i mundur zbatimi efektiv i Ligjit Nr. 7929/1995. Identifikimi i institucioneve është bërë për t'i shtuar atyre kompetenca dhe jo për të krijuar institucione ose struktura të reja, kjo, edhe për të mos rritur shpenzimet buxhetore.
- Krijimi i bazës ligjore të konsoliduar në rastin e prerjes së pemëtoreve për shkak të ndryshimit të ekonomisë bujqësore por pa ndryshuar statusin juridik të tokës bujqësore kjo paraqet interes ekonomik të fermerit ose pronarit të tokës i cili ka të drejtë të ndryshojë kultivarin e mollës, qershisë, dardhës, etj., ose të kalojë në kultura të tjera. Në një treg ku kërkesa për një produkt bujqësor luhetet ndjeshëm, prerja dhe mbjellja e kulturave të tjera është zgjedhje e fermerit me synimin sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme nga aktiviteti bujqësor. Gjithashtu në disa raste del e nevojshme zhvendosja e pemtores në një mjedis më të përshtatshëm. Ligji Nr. 7929/1995 bën një dallim të qartë mes pemëtoreve ku lejohet prerja ndërsa ullishteve që kanë rregullim të diferencuar në nenin 8/1 ku lejohet vetëm zhvendosja e tyre.
- Ruajtja e rrënjëve të ullirit nëpërmjet zhvendosjes së tyre ka rëndësi shumë të madhe në rastin e zhvillimit të territorit në përputhje me legjislacionin e planifikimit del e nevojshme zhvendosja e rrënjëve të ullinjve për pjesën brenda një pasurie të paluajtshme sipas lejes së zhvillimit/ndërtimit. Rrënjët e ullirit mund të zhvendosen brenda të njëjtës pronë që zhvillohet, në prona të tjera kufitare ose në parcela të tjera.

Disavantazhet:

- Rishikimi kërkon kohën e nevojshme për punën dhe miratimin e tij gjë që mund të ketë efekte të vonës në lidhje me zbatimin e zgjidhjeve për problematikat aktuale.
- Nëse rishikimi nuk është i plotë dhe i thellë, nuk arrin të përmbushë qëllimin për adresimin e të gjitha çështjeve, duke lënë disa probleme ende të pazgjidhura.

Ky opsion përfaqëson zgjidhjen e menjëhershme dhe afatgjatë për trajtimin e çështjeve për të cilat ai ofron një bazë solide për të adresuar problematika ekzistuese, për të harmonizuar politikat kombëtare me standartet evropiane dhe për të ndërtuar një sistem më efikas dhe të qëndrueshëm në fushën e politikës për tokat bujqësore në administrim të MBZHR-së.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion të ishte një forcim i funksioneve që ushtrohen aktualisht pa nevojën e miratimit të një ligji të posaçëm dhe mund të përfshijë:

Përforcimin e mbikëqyrjes dhe menaxhimit ekzistues pa ndryshuar legjislacionin. Qeveria mund të fokusohet në forcimin e zbatimit të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues, përmes trajnimeve dhe mbikëqyrjes më të fortë të institucioneve dhe operatorëve të sektorëve. Inkurajimi i fermerëve dhe shfrytëzuesit të tjerë të tokave bujqësore për zbatimin e metodave të reja inovative dhe teknologjive të reja pa imponuar rregullore të detyrueshme. Kjo do të përfshinte fushata edukative dhe informuese, trajnime intensive jo vetëm stafit administrativ e zbatues por edhe të fermerëve si dhe ofrimin ndihmës së nevojshme, udhëzimeve për të ndihmuar ata gjatë zbatimit të procesit.

Ky nuk është opsioni i duhur për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural sepse mënyrat për të zhvilluar bujqësinë të cilat propozohen me këto ndryshime ligjore nuk kanë funksionuar deri më tani pa parashikime ligjore. Është pikërisht detyrimi ligjor i cili do të mundësojë ruajtjen e pemëve frutore, sidomos të ullirëve që ka një jetëgjatësi shumë dekadëshë. Kjo sepse për zhvilluesin e një projekti pemët drufrutore mund të mos trajtohen në përputhje me rëndësinë që ato paraqesin në bujqësi, efektet pozitive në mjedis, interesin dhe ruajtjen e investimit të fermerit në to etj. Për këtë arsye ministria vendosi që përcaktimet të tilla të jenë pjesë e detyrimeve të parashikuar dhe rregulluara specifikisht përmes dispozitave ligjore.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni)*

Grupet e prekura ~~nga ky problem~~ janë:

- *Operatorët e bizneseve të frutave që vijnë nga drufrutorët, tregëtarët e fidanëve etj.;*
- *Qeveria;*
- *Fermerët kultivues;*
- *Komuniteti dhe shoqëria civile;*
- *Zhvilluesit dhe investitorët në infrastrukturë dhe ndërtim.*

Projektligji ndikon në mënyra të ndryshme mbi këto grupe:

o **Qeveria**- ndikimi i qeverisë në zhvillimin e drufrutorëve në zhvillimin e drufrutorëve është i madh dhe mund të jetë vendimtar për suksesin e këtij sektori. Politikat e duhura financiare, infrastrukturore, mjedisore, bujqësore dhe tregëtare mund të ndihmojnë fermerët, komunitetet dhe bizneset të përfitojnë maksimalisht nga kultivimi i drufrutorëve.

o **Fermerët**- të cilët kanë objekt të tyrein kultivimin e drufrutorëve përfitojnë në disa aspekte stabilitet në investimin e tyre, ruajtje e fondit të rrënjëve të bimëve, në rast prerje sipas projektligjit, është parashikuar mundësia e zëvendësimit me mbjellje të reja në ngastrat ku bëhet investimi ose në rajonin përreth duke bërë të sigurtë këtë sektor në shumë dimensionet.

o **Komuniteti dhe shoqëria civile**- kultivimi i drufrutorëve sjell përfitime të shumta për komunitetin, duke ndikuar pozitivisht në ekonominë lokale, mjedisin dhe cilësinë e jetës së banorëve.

Disa përfitime kryesore janë:

Përfitime ekonomike

- a) *punësim i qëndrueshëm*- kultivimi, kujdesja dhe vjelja e frutave krijojnë vende punë për banorët lokalë, restorantet dhe përpunuesit e produkteve ushqimore;
- b) *zhvillim i biznesit lokal*- fermat dhe prodhuesit e frutave mund të mbështesin bizneset e vogla si tregjet lokale, restorante dhe përpunuesit e produkteve ushqimore;
- c) *mundësi për eksport* – komuniteti që kultivon etj.

Përfitime në përmirësimin e hapësirave publike dhe jetës urbane.

- a) *estetikë dhe mirëqënie*- pemët përmirësojnë pamjen, mjedisin urban dhe rural duke krijuar një atmosferë mjedisore të këndshme dhe relaksuese;
- b) *ulja e temperaturave*- pemët frutore ndihmojnë në freskimin e zonave urbane dhe rurale, duke reduktuar efektin e nxehtësisë në qytete;
- c) *promovimi i turizimit rural*- komuniteti mund të tërheqë vizitorë për agroturizëm dhe aktivitete të tjer, duke sjelle veç të tjerash edhe përfitime ekonomike.

o Operatorët e bizneseve- të cilët mund të jenë tregtarë, grumbullues, eksportues të prodhimeve të drufrutorëve, apo tregëtues të plehërave kimikë/organikë të cilët përdoren për shëndetin e tyre etj do të përfitojnë nga risitë e këtij projekligji pasi drufrutorët nuk do të rrezikohen më nga prerjet e panevojshme, të cilat shkaktohen nga përfundimi i kontratës së qiramarrjes së tokës bujqësore apo zhvillimet e territorit etj. kjo me pasojë rritjen e prodhimit, stabilitet në këtë fushë të bujqësisë etj. Prodhimi i fidanëve të ullirit është kompleks, pasi aktiviteti i fidanishteve nuk mund të konceptohet i ndarë nga kërkesat e tregut të prodhuesve të ullirit, nga mbështetja e tyre nga institucionet shkencore dhe autoritetet qeveritare.

Disa nga grupet e prekura kanë përfitime të drejtëpërdrejta si vijon:

Ndikimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të hartimit të projektligjit të ri:

1. Ndikimet Sociale:

a. Operatorët e Bizneseve:

- Forcimi i tregut të brendshëm përmes rritjes së standardeve në cilësinë e produkteve;
- Më shumë mundësi për partneritete dhe bashkëpunime ndërkombëtare, veçanërisht me tregun evropian;
- Përfitime të reja për punonjësit nga rritja e kërkesës për produkte cilësore, duke përmirësuar kushtet e punës dhe zhvillimin profesional të stafit.

b. Qeveria:

- Përfitime lidhur me ecurinë në procesin për konsolidimin të tokës, dhënie dhe përdorim i më shumë toka bujqësore në administrim të shtetit, stabilitet dhe siguri dhe fermerin si cili ka objekt veprimtarie kultivimin e drufrutorëve, ullirit, përditësim të politikave në ndihmë dhe mbështetje të fermerit, më pak problematika gjatë zbatimit të planeve të ndryshme të zhvillimeve etj.;
- Përparim i rëndësishëm në aspektin e plotësimit të kushteve të BE-së, përmirësimin i imazhit të vendit në tregun evropian;
- Përfitimi i një sektori më të kualifikuar, përditësuar dhe forcimi kuadri ligjor përmes miratimit të ndryshimeve ligjore të propozuara;
- Siguri dhe stabilitet në këtë sektor të bujqësisë.

c. Fermerët dhe pronarët e tokave përfitojnë:

- Stabilitet ekonomik, siguri gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre ekonomike;
- Sigurime shëndetësore për fermerët dhe familjet e tyre si rezultat i praktikave më të sigurta dhe më të kontrolluara të prodhimit;

ç. Ndikime sociale:

- Përfitimi i të drejtave më të qarta dhe të zbatueshme për menaxhimin e pemëtoreve dhe ullishtave ndikon pozitivisht në sigurinë juridike dhe qartësinë mbi të ardhmen e investimeve të tyre;
- Ndihmon në ruajtjen e trashëgimisë bujqësore dhe lidhjes së komunitetit me tokën dhe kulturat tradicionale.

d. Komuniteti dhe shoqëria civile:

- Punësim i qëndrueshëm për shkak të kultivimit, kujdesjes dhe vjeljes së frutave do të krijojnë vende punë për banorët lokalë, restorantet dhe përpunuesit e produkteve ushqimore;
- Zhvillim të biznesit lokal sepse fermat dhe prodhuesit e frutave mund të mbështesin bizneset e vogla si tregjet lokale, restorante dhe përpunuesit e produkteve ushqimore;
- Mundësi për eksport;
- Përfitime në përmirësimin e hapësirave publike dhe jetës urbane;
- Estetikë dhe mirëqenie sepse pemët përmirësojnë pamjen, mjedisin urban dhe rural duke krijuar një atmosferë mjedisore të këndshme dhe relaksuese;
- Ulja e temperaturave sepse pemët frutore ndihmojnë në freskimin e zonave urbane dhe rurale, duke reduktuar efektin e nxehtësisë në qytete;
- Promovimi i turizmit rural- komuniteti mund të tërheqë vizitorë për agroturizëm dhe aktivitete të tjer, duke sjelle vec të tjerash edhe përfitime ekonomike.

2. Ndikimet Ekonomike:

a. Operatorët e Bizneseve:

- Përfaqësimi me standarte në tregun bujqësor europian me vendet e tjera të BE-së do të rrisë mundësitë për zhvillimin e ekonomisë vendase dhe rritjen e të ardhurave. Investime më të mëdha në këtë fushë marrë në tërësi, aftësi për përfitime subvencionimesh, programeve mbështetëse, tregëtim i produkteve bujqësore më të sigurta në treg etj. Prodhimi i fidanave të ullirit është kompleks, pasi aktiviteti i fidanishteve nuk mund të konceptohet i ndarë nga kërkesat e tregut të prodhuesve të ullirit, nga mbështetja e tyre nga institucionet shkencore dhe autoritetet qeveritare.

b. Qeveria:

- Stabilitet ekonomik në këtë sektor të bujqësisë;
- Përforsim të kuadrit ligjor dhe përditësim sipas nevojave aktuale të zhvillimeve në bujqësi dhe zhvillimeve territoriale;
- Përfitime të shumëfishta si rrjedhojë e miratimit të politikave të suksesshme të cilat zgjidhin problematika në fushën e zhvillimit të planeve territoriale pa cenuar bujqësinë, stabilitet dhe siguri në sektorin e bujqësisë.
- Plotësimin e objektivave sipas programit të saj 2021-2025.

c. Fermerët:

- ✓ Përfitime ekonomike:

- Të ardhura të qëndrueshme sepse frutat kanë kërkesa të larta në treg, duke u siguruar kështu fermerëve të ardhura të rregullta;
 - Vlerë e shtuar përmes përpunimit pasi përpunimi i lëngjeve, reçelit, frutave të thata, vaj ulliri, apo produkteve të tjera rrit vlerën e frutave dhe fitimet gjithashtu;
 - Diversifikimi i prodhimit sepse fermerët mund të rrisin fitimet duke kultivuar disa lloje frutash që piqen në periudha të ndryshme të vitit;
 - Rritje të eksportit sepse fermeri që kultivon druftorë mund të hyjnë në tregje ndërkombëtare, duke sjellë të ardhura dhe zhvillime ekonomike duke siguruar të ardhura të qëndrueshme. Mundësohen fleksibilitet për të ndryshuar kulturat bujqësore në funksion të kërkesës së tregut, duke ndikuar drejtpërdrejt në të ardhurat dhe qëndrueshmërinë ekonomike të fermës;
 - Rregullimi i procedurës së zhvendosjes së ullinjve shmang humbjet ekonomike që vijnë nga ndalimi total i zhvillimit në parcela me ullinj, duke mundësuar që toka të përdoret në mënyrë më efikase.
- ✓ Përfitime sociale për fermerët:
- Punësim i qëndrueshëm sepse kultivimi i frutave krijon vende pune në fazat e mbjelljes, mirëmbajtjes, korjes dhe përpunimit;
 - Përmirësimin e sigurisë ushqimore sepse fermerët kanë akses të drejtpërdrejtë në fruta të freskëta, të pasura me lëndë ushqyese;
 - Rrit vlerën e pronës sepse fermerët që kultivojnë pemë frutore rrisin vlerën e tokës për shkak të potencialit ekonomik dhe estetik;
 - Turizmi rural pasi fermerët mund të përfitojnë nga agroturizmi, duke ofruar vizita dhe eksperiencë për turistët etj.

3. Zhvilluesit dhe investitorët në infrastrukturë dhe ndërtim:

a. Ndikime sociale:

- Më shumë mundësi për të zhvilluar projekte në përputhje me legjislacionin e planifikimit, hapësira ligjore të cilat mbrojnë interesin e tyre, stimulojnë rritjen dhe progresin pa pengesa të panevojshme.

b. Ndikime ekonomike dhe financiare:

- Mundësia për zhvendosje të rrënjëve të ullirit ndihmon në realizimin e projekteve ndërtimore, por krijon një kosto shtesë për zhvendosjen e këtyre rrënjëve që duhet përballuar nga vetë zhvilluesi.

c. Ndikime mjedisore:

- Parashikimi ligjor për zhvendosjen, prerjen vetëm në disa raste të veçanta dhe zëvendësimin e drurëve të prerë për disa kultura, kontribuon në minimizimin e dëmeve ekologjike dhe ruajtjen e pasurisë natyrore në zonat e zhvilluara.

4. Institucionet akademike dhe kërkimore (Universitetet, QTTB, etj.):

a. Ndikime sociale:

- Rritet bashkëpunimi me institucionet publike dhe fermerët për transferimin e njohurive, duke përmirësuar aftësimin profesional dhe ndikimin social të universiteteve në komunitet.

b. Ndikime ekonomike dhe financiare:

- Mundësia për të përfituar nga projekte të reja për kërkime ose konsulencë mbi llojet e kultivarëve të përshtatshëm për kushtet lokale ose për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve në terren.

c. Ndikime mjedisore:

- Mbështetje për zbatimin e politikave për mbrojtjen e varieteteve me vlerë gjenetike dhe ofrojnë ekspertizë për menaxhimin e biodiversitetit.

5. Komunitetet lokale dhe publiku i gjerë:

a. Ndikime sociale:

- Ruajtja e ullahtave dhe pemëve më jtgjatësi të lartë si pjesë e identitetit kulturor dhe krahinor ka vlerë simbolike dhe shpirtërore për komunitetin;
- Qartësimi i procedurave ndihmon në shmangien e konflikteve sociale për përdorimin e tokës.

b. Ndikime ekonomike:

- Mbrojtja e produkteve tradicionale si ulliri ndikon pozitivisht në turizmin bujqësor dhe ekonominë lokale.

c. Ndikime mjedisore:

- Ruajtja e fondit ekzistues të pemëve ndihmon në uljen e degradimit të tokës, mbrojtjen nga erozioni dhe përmirësimin e klimës mikro-lokale.

Në përgjithësi kultivimi i drufrutorëve është një investim afatgjatë që i sjell fermerëve përfitime të qëndrueshme, duke ndihmuar njëkohësisht ekonominë dhe mjedisin.

Kosto të drejtëpërdrejta në sektorin publik: Momentalisht nuk identifikohen kosto në sektorin publik pasi kompetencat e parashikuara me këtë ligj do të ushtrohen nga strukturat ekzistuese të MBZHR-së dhe institucioneve të saj të varësisë.

Përfitime të drejtëpërdrejta në sektorin publik: qeveria përfiton rritjen e tregut të punës me krijimin e më shumë vende punë në sektorin privat por prespektiva për punësimin e më shumë profesionistëve në publik është gjithashtu e lartë, pasi me zhvillimin e një ekonomie stabile në këtë sektor.

Kostot e drejtëpërdrejta për sektorin privat: nuk identifikohen kosto në sektorin privat me miratimin e këtij projekligji.

Përfitimet ekonomike për sektorin privat: për operatorët e bizneseve, fermerët, përfitimet janë - rritja e cilësisë së produkteve, mundësi eksportimi në vendet e BE-së, stabilitetin e tregut të brendshëm, rritje e të ardhurave, përdorimi i drufrutorëve si investim afatgjatë. Rritja e vlerës së produkteve së prodhuara nga frutat, krijimi i vëndeve të reja të punës në fushën e përpunimit, grumbullimit, transport, shitje, eksport etj. Zhvillime në sektorin e

teknologjisë gjithashtu duke prodhuar më shumë paisje teknologjike që përdoren në sektorin e kultivimit dhe përpunimit të frutave.

Ndikimi social i drejtpërdrejtë: krijimi i vendeve të reja të punës-kultivimi, korrja dhe përpunimi i frutave ofron mundësi punësimi për fermerët, punëtorët sezonalë dhe përpunuesit. Rritjen dhe qëndrueshmërinë e të ardhurave për familjet rurale, përmirësimin e standardeve të jetesës, zvogëlimin e migrimit nga zonave rurale apo emigrimin.

Ndikim jo të drejtpërdrejtë: identifikohen disa ndikime jo të drejtpërdrejta siç janë përfitimet afatgjata dhe efekte të ndërlidhura me disa fusha të jetës siç janë ato sociale, ekonomike. Disa rendisim zhvillimet e shërbimeve publike duke përdorur të ardhurat e vjela nga ky sektor në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë.

Ndikimi në mjedis: Projektligji synon që të rrisë stabilitetin në bujqësi kultivimi i sigurtë dhe afatgjatë i bimëve siç janë ullinjë sjellin edhe krijimin e zonave të sigurta të gjelbra të cilat nuk do të rrezikohen më nga zhvillimet territoriale kjo me ndikim pozitiv kundrejt ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale. Ndikim i rëndësishëm me ipakt mjedisor është edhe ruajtja e rrënjëve të ullirit përmes zhvendosjes kontribuon në mbrojtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore. Lejimi i prerjes së pemëtoreve vetëm për arsye të justifikuara ose për shkak të dëmtuesve redukton dëmtimet mjedisore të panevojshme gjithashtu ka impakt mjedisor shumë pozitiv.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma për ndryshime legjislative, nënkupton lënien pa zgjidhje të problematikave të evidentuara.

Opsioni 1 - (rregullator): Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri dhe shfuqizimi i ligjit aktual Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”. Ky nuk është opsioni i përshtatshëm për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural sepse në këtë mënyrë nuk trajtohen, zgjidhen një sërë çështjesh problematike në kohë duke mos dhënë kështu rezultatet e duhura.

Opsioni 2 - (rregullator): Rishikimi i Ligjit Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, duke rregulluar disa çështje sipas objektit. Ky opsion paraqet opsionin më të mirë për të arritur qëllimet që ka institucioni në adresimin e problematikave në mënyrë efikase, të shpejtë dhe konkrete. Përditësimi i ligjit në fuqi jep mundësinë e arritjes në mënyrë të kënaqshme të objektivave që janë evidentuar.

Opsioni 3 – (jorregullator): Ky opsion do të materializohej përmes disa formave ku përmëdim forcimin e zbatimit të ligjit aktual në fuqi nga strukturat kompetente egzistuese, trajnimit të stafit, forcimi i kërkesës së llogarisë, rritja e efikasitetit të strukturave përmes përforsimit të kompetencave të tyre etj. Qeveria mund të fokusohet në zbatimin të rregulloreve dhe legjislacionit ekzistues në mënyrë më rigoroze, zhvillimit të trajnimeve të vazhdueshme për stafin sidomos në aspektin e përfutimit të njohurive mbi teknikat inovative në kohë etj. pa nevojën e miratimit të rregullave të reja legjislative.

Opsioni 2 (rregullator), është zgjedhur si opsion i preferuar, sepse ofron qasjen më të mirë për të mundësuar pasurimin e ligjit me mënyrat dhe teknologjitë e reja dhe ka pritshmëri të lartë për efektin pozitiv lidhur me cilësinë dhe pjellorinë e tokës në kushtet kur si rezultat i përdorimit intensiv dhe shpesh pa kritere të ekosistemeve natyrore klima në tërësi ka pësuar ndryshime negative duke rezultuar në ngrohjen globale. Ndryshimet e propozuara kanë pritshmëri të madhe lidhur me përmirësimin e situatës aktuale në fushën e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bujqësisë në sektorin e mirëqenies së drufrutorëve.

Zgjedhja e këtij opsioni si opsion i preferuar do të bëjë të mundur rritjen në katër fusha të rëndësishme në të njëjtën kohë:

1. Ekonomi;
2. Garantimi i cilësisë së ushqimit;
3. Shëndeti i kafshëve;
4. Përmirësimi i kushteve mjedisore.

Ndryshimet ligjore të propozuara kanë për qëllim përditësimin e ligjit aktual i cili është miratuar në vitin 1995 dhe si i tillë ka nevojë për përditësim për t'iu përshtatur dhe për të qenë në koherencë me ndryshimet që kanë ndodhur ndër vite në bujqësi. Ndër risitë që sjell ky projektligj po rendisim:

- Si kryhet prerja dhe marrja e miratimit për të?!
- Cilët janë llojet e drufrutorëve të cilët lejohen të priten si dhe arsyet për këtë?!
- Procedura e miratimit të lejes për prerjet etj.
- Rregulla lidhur me zhvendosjen e drufrutorëve si dhe parashikime lidhur me kundravajtjet administrative.

Propozimi ynë konkretisht shton nenin 8/1, dedikuar për ullirin, koleksionet e pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimët e veçuara që kanë vlera gjenetike. Është mbajtur në konsideratë fakti se ulliri mbillet për prodhim, dekoracion, si dhe ka jetëgjatësi më të madhe se pemëtoret e llojeve të tjera.

Ndryshe nga pemët frutore, agrumet dhe vreshtat, që hyjnë në prodhim shumë shpejt dhe kanë një cikël prodhimi që shkon deri në 50 vjet në varësi të kulturës dhe llojit të kultivarit, ulliri hyn në prodhim më vonë dhe ka jetëgjatësi shekullore.

Projektligji lejon zhvendosjen e rrënjëve të ullirit nga zhvilluesi në bashkëpunim me pronarin e tokës, vetëm në rastet ku ka leje ndërtimi të miratuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Në këto raste zhvendosja e rrënjëve të ullirit ndodh për shkak se toka ndryshon destinacionin për ndërtim, pas kalimit të gjithë fazave ligjore deri në miratimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit. Në këtë mënyrë ruhet numri i rrënjëve të ullirit pavarësisht dinamikave që ka planifikimi dhe zhvillimi i territorit. Kostot për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit përballohen nga subjekti zhvillues/pronari.

Duke njohur rëndësinë e koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimët e veçuara që kanë vlera gjenetike, lejohet zhvendosja vetëm në rastet ku ka leje

objekte publike të miratuar nga organet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zhvendosja kryhet nga zhvilluesi në bashkëpunim me pronarin e tokës. Kostot e zhvendosjes përballohen nga buxheti i shtetit i alokuar për realizimin e projektit. Ndërkaq neni 8/1 përcakton gjithashtu dhe ndalimet për zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtje. Projektligji që propozohet prek veçanërisht rrënjët e ullirit të cilat janë më problematike për shkak të kushteve dhe jetës së gjatë që ka pema e ullirit.

Nga analiza me shumë kritere e kryer për të tre opsionet rezulton se Opsioni 2 , kryerja e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore” është vlerësuar me më shumë pikë, duke e zgjedhur si option të preferuar.

Për të vlerësuar opsionet dhe për të bërë të mundur një krahasim më të saktë ndërmjet tyre është kryer analiza me shumë kritere dhe janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Janë listuar të gjithë opsionet e marra në konsideratë gjatë analizës (përmendur më lart);
2. Janë përcaktuar kriteret relevante për matjen e objektivave;
3. **Është përcaktuar pesha e secilit kriter sipas rëndësisë relative.**

Në vijim të arritjes së synimit përfundimtar për përzgjedhjen e Opsionit 2 si optioni i preferuar nga ana jonë është kryer analiza me shumë kritere e cila ka disa hapa siç janë përcaktimi i kriterëve, vendosja e peshës etj.

1. Efektiviteti në ushtrimin e detyrave të përcaktuara në ligj nga institucionet përgjegjëse - 4
2. Efektiviteti në rregullimin e procesit të ndryshimit të ekonomisë bujqësore nga rritja e pemëve në kultura të tjera - 4
3. Efektiviteti i garantimit të mbrojtjes së ullirit, koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimëve me vlera gjenetike - 5
4. Efektiviteti i zbatimit të ndalesave mbi zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtjeje - 5
5. Kosto - efektiviteti - 5

Për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e optionit më të mirë, secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5. Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo option për secilin kriter nga 0-5, ku 0 përfaqëson optionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Matrica e performancës: Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3

	(Rëndësia relative)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në ushtrimin e detyrave të përcaktuara në ligj nga institucionet përgjegjëse	3	1	3	3	9	3	9	2	6
Efektiviteti në rregullimin e procesit të ndryshimit të ekonomisë bujqësore nga rritja e pemëve në kultura të tjera	4	1	4	4	16	4	16	1	4
Efektiviteti i garantimit të mbrojtjes së ullirit, koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve, ullinjve dhe vreshtave, si dhe bimëve me vlera gjenetike	5	0	0	5	25	5	25	0	0

Efektiviteti i zbatimit të ndalesave mbi zhvendosjen e rrënjëve të ullirit brenda zonave të mbrojtura që kanë regjim të veçantë mbrojtjeje	5	0	0	5	25	5	25	0	0
Kosto-efektiviteti	5	0	0	3	15	5	25	0	0
Pikët totale për secilin opsion		7		90		100		10	

Analiza me shumë kriterë tregon se Opsioni 2, përditësimi i Ligjit Nr. 7929, datë 11.5.1995, “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, është vlerësuar me më shumë pikë dhe është zgjedhur si opsionin i preferuar.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Zbatimi i opsionit të zgjedhur do të realizohet në përputhje me dispozitat përcaktuese të këtij projektligji. Autoritetet përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e tokave bujqësore janë drejtoria përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe autoritetet përgjegjëse siç vijon:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
2. Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve;
3. Drejtoritë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor;
4. Bashkitë, përkatësisht drejtoritë përgjegjëse për bujqësinë në bashki;
5. Institucionet përgjegjëse për kulturat drufrutore.

- **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**, është përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën mbrojtjes dhe shfrytëzimit të tokave bujqësore në administrim të MBZHR-së. Si autoriteti kompetent qendror MBZHR koordinon punën e institucioneve të varësisë.

- **Autoriteti Kompetent për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve** - merr masa për evidentimin e risqeve sipas fushave të përgjegjësisë, të dhënat raportohen menjëherë në institucion për mundësimin e miratimit të planeve për t'u zbatuar, akteve nënligjore për shmangien e vonesave apo risqeve.

- **Drejtoritë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor** - ushtrojnë kompetencat e tyre si në aspektin e monitorimit/këshillimit po ashtu edhe të ndërmarrjes së masave në aspektin fitosanitar.

- **Bashkitë, përkatësisht drejtoritë përgjegjëse për bujqësinë** - në bashki ushtrojnë kompetenca në zbatim të ligjit dhe kanë detyra monitoruese/këshilluese mbi tokat bujqësore në administrim të bashkive.

Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Risqet mund të jenë disa:

- mungesa e një analize të mirëfilltë të tregut;
- vendosja e objektivave të paqarta ose jorealiste;
- mungesa e një strategjie afatgjatë.

Disa nga masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës janë:

- politikat do të hartohen bazuar në të dhëna të sakta mbi ofertën e tregut dhe kërkesën e tregut për produktet që vijnë nga drufrutorët;
- hartimi i planeve të mirëmenduara do të sjellin rezultate të suksesshme dhe të arritshme;
- politikat e hartuara do të fokusohen në plane afatgjata duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së opsionit të preferuar do të kryhet nga drejtoria përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si institucion përgjegjës për hartimin për tokat bujqësore në administrim të saj.

Monitorimi në terren në lidhje me objektivat ligjore për tokat bujqësore do të kryhet nga MBZHR dhe institucionet e saj të varësisë, në bashkëpunim me bashkitë, këshillat e qarqeve, prefekturat dhe strukturat e tjera të ngarkuara nga ligji në fuqi.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit është i ndarë mes Drejtorisë/Sektorit të Mbrojtjes së Tokës Bujqësore dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës po ashtu në Ministri.

Mekanizmat Mbështetës për Monitorim dhe Vlerësim:

Shkëmbimi i informacionit, të dhënave, raportet periodike dhe përfundimtare mes institucioneve të ngarkuara për monitorimin në terren të zbatimit të ligjit. Bashkëpunimi mes institucioneve të qeverisjes qëndrore (MBZHR dhe institucionet e varësisë) me pushtetin vendor (bashkitë, prefekturat, institucionet e zhvillimit të territorit etj.) do shërbejë si masë për monitorimin e zbatueshmërisë së opsionit të preferuar dhe arritjes së objektivave.

Disa prej treguesve që do të shërbejnë për matjen e arritjes së objektivave janë:

1. Numri i struktura përgjegjëse në nivel qendror, vendor dhe çdo institucion tjetër, që mund të ngarkohet me zbatimin e këtij ligji;
2. Numri i kërkesave për prerje/zhvendosje të trajtuara sipas procedurës së re;
3. Numri i rrënjëve të ullirit të zhvendosura në përputhje me ligjin;
4. Përqindja e ullinjve të zhvendosur të kryer me sukses pa dëmtuar rrënjët;
5. Numri total i rrënjëve të mbjella për çdo zhvendosje të ullinjve sipas parashikimeve të këtij ligji;
6. Numri i miratimeve të strukturave në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë për prerjet sipas nenit 7 të ligjit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milion lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										

Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milion lekë		Vlera aktuale neto në milion lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			